# RAPORTI MBI
# DEGJESAT PUBLIKE
# PER
# BUXHETIN AFATMESEM
# PBA 2025-2027

*(Bazuar në materialet prezantuese të hartuar nga cdo drejtor i menaxhimit të programit gjatë organizimit të dëgjesave publike, diskutimeve dhe sugjerimeve të pjesmarrësve etj.)*

*Përgatiti: Myfarete Malasi*
*Përgjegjëse Sektorit të Analizës Statistikës dhe Planifikimit Afatmesëm*
*Drejtoria e Buxhetit*
*Bashkia Durrës*

**Raporti përfundimtar mbi Dëgjesat Publike për Buxhetin afatmesem (2025-2027)**

Në kuadër të përgatitjes dhe hartimit të Buxhetit Afatmesëm 2025-2027, si dhe në kuadër të transparencës publike lidhur me të gjitha projektet, shërbimet dhe investimet e realizuara përgjatë vitit 2024, si dhe rëndësisë që kanë Dëgjesat Publike për informimin, edukimin, thithjen e informacionit dhe angazhimit të publikut për ceshtje të ndryshme, u organizuan dëgjesat publike, për programet kryesore të zhvillimit të Bashkisë Durrës.
Bazuar në Ligjin 146/2014 "Për konsultimin publik", Bashkia ka krijuar të gjitha mundësitë për të siguruar pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në proçesin e hartimit të buxhetit vjetor dhe sidomos të prioriteteve buxhetore, si dhe për të mirëpritur çdo propozim nga ana e pjesëmarrësve.
Ky raport përmbledhes, bazuar në kërkesat e ligjit 86/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", do t'i bashkangjitet draftit të PBA-s. Raporti më analitik i dëgjesave publike nga cdo drejtori dhe për cdo program përmban më shumë informacion dhe kryesisht:

- Ftesën dhe axhendën e takimit (vendi, ora..)
- Përmbledhjen/broshurën për pjesëmarrësit
- Materialin prezantues (poëer point)
- Përmbledhjen e minutave të takimit
- Listën e firmosur nga pjesëmarrësit
- Foto nga takimi

Si fillim, Bashkia ka përpiluar dhe ka shpallur publikisht (në faqen zyrtare të Ëeb-it të Bashkisë si dhe në Njësitë Administrative përkatëse), Kalendarin e Dëgjesave Publike për çdo Drejtori të Bashkisë, sipas Programeve respektive që do të zbatohen për periudhën 2025-2027.
Gjithashtu, me qëllim sigurimin e pjësemarrjes në dëgjesat publike, të gjitha palët e interesuara (aktorët publik/privat) u njoftuan edhe në rrugë zyrtare dhe në formë elektronike lidhur me qëllimin e dëgjesës publike, axhendën si dhe materialin analitik shpjegues për çdo program zhvillimi. Për më tepër, çdo dëgjesë publike u pasqyrua nëpërmjet komunikatave të njëpasnjëshme për shtyp.
Për realizimin në kohë dhe me efiçencë të dëgjesave publike, Sektori i Analizës së Statistikave dhe Planifikimit Afatmesëm në Drejtorinë e Buxhetit pranë Bashkisë Durrës, asistoi çdo drejtori lidhur me përpilimin dhe shpërndarjen e ftesave (në rrugë zyrtare dhe formë elektronike), axhendës si dhe përgatitjen e materialeve dhe prezantimeve sipas programeve. Gjithashtu, ky sektor, organizoi dhe të gjithë procesin e organizimit në terren dhe protokollimit të minutave të dëgjesave publike.
Në çdo dëgjese publike, pjesëmarrësit u informuan nëpërmjet prezantimeve dhe broshurave mbi investimet, projektet dhe shërbimet kryesore për secilën nga Programet që Bashkia ka parashikuar të zbatojë për periudhën e buxhetimit 2025-2027, si më poshtë vijon:

- Programi “Investimet në Infrastrukturën Rrugore dhe Transportin Publik”;
- Programi “Shërbimet Sociale”
- Programi “Arsimi Parashkollor dhe Parauniversitar”;

Cdo dëgjesë u drejtua nga drejtorët e menaxhimit të cdo programi. Pjesë e rëndësishme e këtyre dëgjesave ishin dhe përfaqësues të komisioneve respektive të Këshillit të Bashkiak të Bashkisë Durrës, përfaqësues të projektit: “Bashki të Forta”, si dhe OJF-ve të cilat aderojnë me projekte të ndryshme , si Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile Durrës, të cilat aktualisht në kuadrin e: “Përmirësimit të procesit të Buxhetimit të Konsultuar dhe me Pjesëmarrje” ka bashkëpunuar me Bashkinë Durrës, për rritjen e aksesit të qytetarëve në hartimin e buxhetit, , ku cdo qytetarë shpreh preferencat dhe sugjerimet e tij për prioritetet në Buxhetin e Bashkisë Durrës, propozimet e të cilëve, iu përcollën dhe Këshillit Bashkiak.
Propozimet nga qytetarët dhe grupet e interesuara u sistemuan sipas emërtimeve të programeve, duke vecuar kërkesat për investime.
Mbi bazën e tyre drejtorët e menaxhimit të cdo programi:

- do të zgjedhin ato projekte, të cilat përputhen me politikat sipas strategjisë së zhvillimit, apo ato që janë emergjente,
- do të përgatiten për diskutimin dhe përzgjedhjen e tyre nga grupi për buxhetimin strategjik,
- do te marrin miratimin nga kryetari dhe do të reflektohen në draftin e dokumentit të PBA të rishikuar 2025-2027.
- në muajin gusht publikohet nga bashkia dokumenti i rishikar i PBA (sipas ligjit 67/2017).
- për projektet e vitit të parë të PBA-s, fillon përgatitja e fishave dhe tabelave sipas modelit të Ministrisë së Financave.

Bashkia do të vlerësojë edhe propozimet qytetare që lidhen me përmirësimin e shërbimeve dhe komunikimin e informimin më të mirë të tyre gjatë procesit të buxhetimit dhe për çështje të veçanta.

**Përmbledhja e Dëgjesave Publike sipas Programeve për PBA 2025-2027**

Sipas Kalendarit të Dëgjesave Publike të hartuar për Programin Buxhetor Afatmesëm PBA 2025-2027, u organizuan 18 Dëgjesa Publike në të gjitha Nj/Administrative të Bashkisë Durrës, sipas programeve si më poshtë:

- Programi i Projekteve dhe Infrastrukturës Publik 6 Dëgjesa Publike
- Programi mbi projektet e Shërbimit Social 6 Dëgjesa Publike
- Programi Arsimi parashkollorë dhe parauniversitar (investime) 6 Dëgjesa Publike.

Dëgjesat sipas programeve dhe grupimeve paraqiten sipas tabeles së mëposhteme:

| **Dëgjesat sipas programeve dhe grupimeve** | **Nr. Degjesave** |
|---|---|
| Programi i Projekteve dhe Infrastrukturës Publike | **6** |
| Programi i Shërbimeve Sociale | **6** |
| Programi i Arsimit parashkollor dhe ai parauniversitar (investimet) | **6** |
| **Shuma** | **18** |

| Njësitë Administrative | Numri i pjesmarrësve | Rekomandimet nga pjesmarrësit |
|---|---|---|
| Nj.A Manëz-Ishëm | 63 | 10 |
| Nj.A Sukth-Katundi Ri | 102 | 7 |
| Nj.A Nr.5 (Plazh-Shkozet) | 73 | 15 |
| Nj.A Nr.4dhe 6 (Spitall-Kënetë) | 54 | 16 |
| Nj.A Nr. 1, 2 dhe 3 | 37 | 7 |
| Nj.A Rrashbull | 70 | 18 |
| **Total:** | **399** | **73** |

**Në këto 18 Dëgjesa Publike, morën pjesë rreth 399 pjesëmarrës**, përfaqësues të komunitetit, grupe të interesuara, subjekte, institucione shtetërore, të zgjedhur vendore, pëfaqësues të biznesit, shoqëri civile etj., të cilët përfshinë të gjithë territorin e Bashkisë.

Gjatë organizimit të këtyre Dëgjesave Publike, u diskutua për investimet, shërbimet dhe projektet sipas programeve që ka kryer Bashkia si dhe rekomandimet dhe sugjerimet e dala nga pjesëmarrësit.
Numri në total i rekomandimeve të dala nga këto Dëgjesa Publike është **73** rekomandime.

## Dëgjesat Publike 2025-2027

**Dëgjesa I**

Data 07.10.2024.

Vendi i takimit: Kompleksi "Reon", Manzë.

Ora: 10°°-14°°

Në këtë takim, kishte një pjesmarrje të gjërë, ku të pranishëm ishin përfaqësues të komunitetit të Njësive Administrative Manëz dhe Ishëm, përfaqësues të grupeve të interesit, Institucioneve Arsimore, OSHE, Emergjenca Civile, OJF që operojne në këto Nj.A.
Pjesmarrës në takim, sipas listë prezencës, 63 persona.

Në takim u prezantuan këto programe:

- Arsimi Parashkollor dhe Parauniversitar. Investimet në arsim për PBA 2025-2027. (DAKRSKF)
- Infrastruktura rrugore &Transporti, investimet për PBA 2025-2027. (DPIP)
- Strehimi dhe Shërbimi Social, projektet e shërbimit Social për PBA 2025-2027. (DSHS)

Takimin e hapi ZV/Kryetari i Bashkisë Durrës, z. Elio Jani, i cili gjatë fjalës së tij përshëndetëse, foli mbi investimet e bëra gjatë vitit 2024, investimet në infrastrukturë rrugore, arsimore.
Disa nga objektivat per vitin 2025-2027 janë:
Ndërtimi i markatës për tregëtimin e produkteve bujqësore në Manëz,
Rikonstruksioni dhe rindërtimi i qëndrave shëndetësore, kopshteve dhe çerdheve
Krijimi i hapësirave publike dhe këndeve të lojërave për fëmijët
Shtrimi i disa rrugëve si Borice, Vora, Kodrashi, Ferhati janë prioritet për vitet e ardhshme.
Ndërsa në fushën arsimore, objektivat për vitin 2025-2027 janë ndërtimi dhe rikonstruksioni i shkollave të arsimit të mesëm dhe konvikteve, si dhe përfundimi i investimeve aktuale që kanë nisur për shkollat dhe kopshtet.
Me tej dëgjesa vazhdoi me prezantimet e tre Programeve Buxhetore për PBA 2025-2027, nga drejtorët e drejtorive përkatëse të Bashkisë Durrës.
Pas prezantimit te ketyre programeve, fjalën e morën banorët dhe të pranishmit në sallë, të cilët diskutuan rreth këtyre prioriteteve, duke dhënë mendimet dhe duke parashtruar ankesat dhe sugjerimet e tyre.

### Dëgjesa publike për Programin "Arsimi parashkollor dhe parauniversitar " dhe programi: "Shërbimet Publike, Investimet në Arsim" PBA 2025-2027

Më pas e mori fjalën Drejtori në Drejtorinë e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe komunitete Fetare, z. Adrian Gurra, i cili bëri prezantimin për programin "Arsimi parashkollor dhe parauniversitar dhe investimet në arsim" **për PBA 2025-2027.**

**Qëllimi i takimit:** Përthithja nëpërmjet Dëgjesave Publike, të mendimeve dhe sugjerimeve të aktorëve të ndryshëm të fushës për të realizuar një buxhet sa më pranë qytetarëve dhe nevojave të tyre. Përcaktimi i prioriteteve të investimeve në Arsim në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së infrastrukturës arsimore, duke ofruar shërbime eficente dhe cilësore për vitin në vazhdim 2024 dhe për projekt buxhetin afatmesëm 2025- 2027.

**Prezantimi i Drejtorit të Arsimit, z. Adrian Gurra**

**z. Gurra** e filloi prezantimin mbi qëllimin e dëgjesës dhe sa i rëndësishëm është fakti që së bashku ne diskutojmë mbi politikat që ka ndjekur Bashkia deri më sot dhe cilat janë ato deri në vitin 2027, duke bërë të qartë për të pranishmit se kush janë politikat tona dhe objektivat për këto vite dhe sesi mendojmë ne që nga diskutimet e përbashkëta të vendosim sa më mirë dhe drejt për prioritetet në fushën e arsimit, kulturës dhe sportit.

Z. Gurra, bëri një analizë të detajuar mbi arsimin dhe objektivat e tij deri në vitin 2027, investimet e bëra nga Bashkia Durrës në vitin 2024, dhe cilat janë ato që do të kryhen për vitet 2025-2027.

z. Gurra, referoi për të gjitha investimet e kryera në Institucionet Arsimore gjatë vitit 2024 duke u ndalur kryesisht për cdo investim të kryer në Njesinë Administrative Manez dhe në Njesinë Administrative Ishëm. Fokusi kryesor i investimeve në arsim, ishte ai i përfundimit të procesit të rindërtimit si dhe në investimet që parashikohen të behen në institucionet arsimore gjatë viteve 2025-2027.

Objektet Arsimore në Njësinë Administrative Manëz dhe Ishëm që kanë përfunduar dhe janë në proces për t'u rindërtuar në vitin 2025 janë si më poshtë:



## Objekte arsimore NJA Manëz

- Shkolla 9 vjeçare "Riza Shera"+ kopesht, Radë (Rikonstruksion dhe shtese, financim me fondet e BE zbatuar UNDP me programin EU4Schools, ka perfunduar ndertimi,pritet lidhja me energji elektrike dhe kolaudimi)
- Shkolla 9 vjeçare "Armath" (Rikonstruksion, bashkëfinancim Bashkia Durrës me FSHZH/ përfunduar në vitin 2019)

  Kopshti Hamallaj/14 femije dhe Kopshti Shkalle/11 femije

  Do shikohet mundesia ne dakortesi me banoret per kalimin me qera te tyre
- Shkolla 9 vjeçare "Zyber Sallaku", Kuçok (Rikonstruksion program CIS/perfunduar dhe inaguruar qershor 2024)
- Kopshti I ri me ushqim "Rreze Drite" prane shkolles 9 vjeçare "Zyber Sallaku" me tre grupe( ndertim I ri me programin EU4 schools perfunduar Shtator 2024)
- Gjimnazi Manez (Ndertim I ri, financim me fondet e Bashkisë Durrës, eshte ne faze vleresimi perfundimtar dhe brenda muajit Nentor 2024 fillon puna).
- Rindertim kopshti "Lulet e Pranveres" (me fondet e FSHZH / perfunduar)

Z. Gurra u ndal dhe në objektivat që Drejtoria e Arsimit në Bashkinë e Durrësit ka për vitin 2025,ku një rendësi e vecantë i është dhënë dhe mirëmbajtjes së ndertesave arsimore.

## OBJEKTIVAT E ARSIMIT

- Drejoria AKRSKF e realizon veprimtarinë e saj nëpërmjet Sektorit të Arsimit dhe Qendrës Ekonomike të Arsimit duke menaxhuar dhe administruar 86 godina arsimore dhe 584 punonjës arsimore.

Në PBA 2025-2027 objektivat e Arsimit janë si me poshtë:

1. Ndertimi dhe rikonstruksioni i shkollave te arsimit te mesem dhe konvikteve
2. Rritja e frekuentimit te nxenesve ne konvikte.
3. Rritja e shërbimeve dhe garantimi i kushteve higjeno-sanitare
4. Rritja e sigurisë në godinat e institucioneve arsimore publike.

**Foto nga Dëgjesa Publike për Programin “Arsimi parashkollor dhe parauniversitar ” dhe programi “Shërbimet Publike, Investimet në Arsim” PBA 2025-2027 në Nj/A Manëz dhe Ishëm**






**Dëgjesa Publike për Programin "Projektet e Shërbimit Social" PBA 2025-2027**

**Drejtoria e Shërbimit Social me NJ. Administrative Manëz-Ishëm**

Më pas e mori fjalën Shefi i Drejtorisë së Shërbimit Social Z. Arlind Vata, i cili bëri prezantimin e **"Projekteve të Shërbimit Social" për PBA 2025-2027.**

**Qëllimi i takimit:** Informimi i pjesëmarrësve me politikat e përmirësimit të kushteve për zhvillimin e sistemit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror në Bashkinë Durrës dhe përmirësimi i shërbimeve sociale në territorin e Bashkisë Durrës për vitin në vazhdim 2024, dhe marrja e opinioneve të tyre për të përmirësuar shërbimet sociale dhe shërbimet e përkujdesit shoqëror për projekt buxhetin afatmesëm 2025-2027.

**Prezantimi i shefit të Drejtorisë së Shërbimit Social**

Shefi i Drejtorisë së Shërbimit Social Z. Arlind Vata, u bëri të ditur pjesëmarrësvese këto takime po bëhen në kuadër të realizimit të dëgjesave publike për të bërë të mundur më pas përgatitjen e Buxhetit Afatmesëm 2025-2027 lidhur me projektet e Shërbimit Social.

Prezantimin e projekteve të shërbimeve sociale e bëri Z. Arlind Vata, i cili theksoi se Bashkia Durrës ka hartuar Planin e shërbimeve sociale, i cili është bazuar në qasjen e ofrimit të një pakete shërbimesh për të gjitha kategoritë e grupeve në nevojë si dhe në filozofinë e ndërtimit të partneritetit midis aktorëve të ndryshëm, si institucionet e qeverisjes vendore dhe rajonale, organizatat ndërkombëtare, kombëtare dhe ato lokale, si dhe biznesin vendor si një mbështetës potencial në fuqizimin e shërbimeve sociale.

Gjatë prezantimit, Z. Arlind Vata bëri një pasqyrë të situates aktuale, detyrat dhepërgjegjësitë e Pushtetit Vendor si dhe u ndal në shërbimet sociale që po kryhen në Bashkinë e Durrësit gjatë vitit 2024 dhe për vitet 2025-2027. Këto shërbime janë si më poshtë:



**Shërbimet**

- **Qendra e Emergjencës(Bashkia+ Ëorld Vison+ Fondi Social)**
- **Qendra Komunitare Multifunksionale Rrashbull**
- **Shtepia eFoshnjes Durres ofron sherbim rezidencial dhe ditor (financohetnga fondet e Ministria e Shendetesise)**

## Qendra Komunitare për Fëmijë me Aftësi të Kufizuar

13

Qendraofron shërbim e që sy nojnë rehabilitim in dhe gjithëpërfshirjen e fëm ijëv e m e aftësi të kufizuara në shkolla dhe kom unitet, nëpërm jet ndërhy rjes m e trajtim e të indiv idualizuara , m bështetjes së fam iljes dhe ndërgjegjësim it kom unitar

1

**Sh ërbi met:**
**I.** Sh ërbim edirektepër fëm ijëtme aftësitë ku fizu ara(2-21 vjeç) në fu sh ëne sjel l jes,kom u nikim ita, u tonom isë,aftësiveakadem ikedh e m otori kës
**II.** Rritje e kapaciteteve të prindërve dh e fam il jarëve për të pu nu ar m e fëmijët në shtëpi dhe për të advoku ar për gjithëpërfshirjen e tyre në arsim dh e kom u nitet.
**III.** N dërgjegjësim i kom u nitetit për të m bësh tetu r gjith ëpërfsh irjen e fëm ijëve m e aftësi të ku fizu.ara

**Total ipërfi tu e:s**
173fëm ijëdh efam il jete tyre

**Aktual i shpt ërfi tu e:s**
82 fëm ijëdh efam il jete tyre

**Fi nanci m:i**
Bash kiaDu rrës






1

## Qendra për Shërbime Mbrojtëse, Fuqizuese dhe Emergjente për Fëmijën dhe Familjen

Qendra ka për mision “Mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror si dhe të ofrojë shërbime që synojnë të ndikojnë pozitivisht në jetën e fëmijëve, të rinjve dhe familjeve të tyre në situatë vulnerabël”, me fokus kryesor mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, abuzimi, neglizhimi dhe shfrytëzimi.

3

**Shërbimet:**

**I. *Shërbimi emergjent i mbrojtjes 72+ orë*** për fëmijët në nevojë për mbrojtje të menjëhershme pa kujdes prindëror ose të dhunuar, fëmijë të rrugës, të shfrytëzuar, të abuzuar dhe gra e fëmijë viktima të dhunës në familje të cilëve ju ofrohet:

- Strehimi
- Mbulimi i nevojave shëndetësore, mirëqenia e fëmijëve
- Mbulimi i nevojave ushqimore
- Manaxhimi i problemeve të shëndetit mendor të fëmijëve
- Sigurimi i materialeve të buta
- Siguria për jetën

**II. *Shërbime mbështetëse me qëllim zhvillimin komunitar***

- Programe për fuqizimin dhe zhvillimin pozitiv të fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve: mbështetje psiko-sociale, trainime, ëorkshope
- Aktivitete komunitare ndërgjegjësuse për rritjen e kapacitetit të tyre në fushat e mirëqënies sociale.

**Totali përfitues:**
316 fëmijë dhe 98 të rritur

**Përfitues 2022:**
164 fëmijë dhe 57 të rritur

**Financimi:**
- Fondi social (MSHMS) – 30%
- Bashkia – 30%
- ëorld Vision – 40%



Prioritet mbeten shërbimet sociale për grupet në nevoje, sidomos në këto Njësite Administrative, sidomos të komunitetit Rom dhe atij Egjiptianë. Për të cilat kjo drejtori do të fokusohet si më poshtë:

**Komunitetin Rom dhe Egjyptian**

**Integrimi i programit të mbështetjes ligjore për regjistrim në Qendrën multifunksionale Nish Tulla;**

**Ofrimi i programeve fuqizuese për familjen.**

**Ofrimi i programeve ndërmjetësuese për punësimin e Komunitetit Rom dhe Egjyptian.**

**Krijimi i mundësive për përfitimin nga programet e strehimit**

**Foto nga Dëgjesa Publike për Programin "Projektet e Shërbimit Social"**
**PBA 2025-2027 në Manëz dhe Ishëm**





## Dëgjesa Publike e Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publik përPBA 2025-2027 në Nj. A Manëz dhe Ishëm

Më pas e mori fjalën Drejtori i Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike , Z. Lorenc Facja, i cili bëri prezantimin e Programit të Projekteve dhe Investimeve të Infrastrukturës Publike për PBA 2025-2027.

**Prezantimi i specialistit të Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike .**

Drejtori i Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike , Z. Lorenc Facja, u bëri të ditur pjesëmarrësve se këto takime po bëhen në kuadër të realizimit të dëgjesave publike për të bërë të mundur më pas përgatitjen e Buxhetit Afatmesëm 2025-2027 lidhur me investimet në infrastrukturën rrugore dhe shërbimet publike.

Z. Lorenc Facja, informoi të pranishmit lidhur me programin e **"Infrastrukturës rrugore dhe Transportit Publik"**, duke u përqëndruar kryesisht në informimin e pjesëmarrësve mbi investimet e kryera gjatë vitit 2024, në Njësine Administrative Manez dhe Ishëm dhe parashikimi për investimet në infrastrukturën rrugore për këto Njësi Administrative gjatë tre viteve në vazhdim 2025-2027. Z. Lorenc Facja, theksoi se:



Gjatë prezantimit, Z. Lorenc Facja, bëri me dije se investimet e kryera nga Bashkia Durrës për vitin 2024 për Nj. Administrative Manëz janë:

## 1. INFRASTRUKTURE RRUGORE TE REALIZUAR NE VITIN 2024

Rruga Ali Gjoka 250 ml

Rruga Sula 595ml

Rruga Gjoka 675 ml

Rruga Ullinjve 620ml

Total 2140 ml





## 2. PASTRIM KANALESH TE REALIZUAR

### Viti 2023

Borç, kanal ujitës I parë: 3330mL

Radë, kanal ujitës I dytë: 2914mL

Armath, kanal ujitës I dytë: 882mL

### Viti 2024

Kanal ujites i pare dhe i dyte 1700ml



z. FAcja prezantoi dhe objektivat 2025-2027, si me poshtë:

## 3. OBJEKTIVAT PER VITIN 2025-2027

1. PROJEKTE NE INFRASTRUKTURE RRUGORE
-Rruga e Borces

-Rruga e Hoxhve

-Rruga Vora

-Rruga Kodrashi

-Rruga Ferhatit

2.PROJEKTE NE INFRASTRUKTUREN PUBLIKE

-Nderim i markates per tregtimin e produkteve buqesore ne Manez

-Rikonstruksion dhe ndertim i qendrave shendetesore

-Rikonstruksion dhe ndertim te kopeshteve/çerdheve

-Krijimin e hapsirave publike dhe kende lodrash per femijesh








**Foto nga Dëgjesa Publike për programin e “Infrastrukturës rrugore dhe Transportit Publik”, për PBA 2025-2027 në Nj.Administrative Manëz dhe Ishëm**





Pas prezantimit të këtyre programeve fjalën e morën banorët dhe të pranishmit në sallë, të cilët diskutuan rreth këtyre prioriteteve, duke dhënë mendimet, dhe duke parashtruar ankesat dhe sugjerimet e tyre.

Pyetje dhe Diskutime

**Manzë dhe Ishëm.**

1. Kryetari i Fshatit Shkallë- Manëz.
   - Zona jonë është zonë bujqësore,fshatarët shpenzojnë për të mbjellat, por në këtë zonë, nuk vjen fare uji për vaditje.
   - Ujë të pijshëm vjen më pak se 20 min në ditë.
   - Nuk pastrohet kanali në këtë zonë.
   - Tre rrugë që janë nisur janë lënë përgjysëm për 50-100m rrugë, Rruga ‘‘Fortuzi‘‘, Rruga ‘‘Djaloshi“, Rruga e Varrezave.
   - Fshati Shkallë ka vetëm 10 min ujë të pijshëm në ditë.

Drejtori i drejtorisë së projekteve: Lidhur me sistemin e vaditjes bashkë me kryetaren do ta shikojmë këtë problem dhe në vitin e ardhshëm sepse ketë vit ka mbaruar fushata e vaditjes të kemi në qendër të vëmendjes Fshatin Shkalle, ndërsa për rrugët Fortuzi , Djalodhi dhe Varrezat do të vijmë ti shikojmë sipas mundësisë të vendosim një prioritet se cila është më emergjente për tu bërë. Ndërsa në lidhje me problemin e ujit të pijshëm nga informacionet që kam marrë po bëhët një procedurë për hartimin e nje projekti që të përfshijë komplet njësinë administrative Manëz për të rishikuar dhe njëherë skemën e furnizimit me ujë . Jam në djeni që fshati Manëz dhe Fshati Shkallë u bë linja e transmetimit nga tubacionet korispondente deri në depo të shpërndarjes është amortizuar, është diskutuar disa herë dhe po diskutohet për një projekt serioz që mos të keni më këto probleme.

2. Banorë Fshati Hamallaj
   - problem Rruga “Shehu”, nuk është një rrugë e mirëfilltë pasi është anash kanalit dhe përbën rrezik për banorët. Kërkohet të sistemohet rruga për të kaluar banorët qoftë dhe pa asfalt.

ZV/Kryetari: Po patjeter do e rishikojmë, do komunikojmë me deputetin dhe kryetarin e njësisë t’jua mundesojmë.

3. Banore: Rruga“Hoxha“, është e prishur dhe plot gropa, pengesë për investimet që janë bërë në këtë zonë.

ZV/Kryetari: Do ta marrim ne konsiderate kerkesen tuaj.Ishëm

4. Inspektor i përgjithshëm i emergjencës civile Ishëm:
   - Në fshatin Draç është emergjente ndërtimi i një Ambulance.

5. Përfaqësuese e Qendrës sociale Paqe dhe Siguri në Durrës:Nevojë për një qendër komunitare ose dicka që mund të sigurojë shërbime për fëmijët dhe gratë.

Drejtor i Drejtorisë së Arsimit: Ne e përmendëm dhe pak më lart që objekti i Shkollës së Mesme të Bashkuar shërben dhe si qënder komunitare, ka një lloj standarti që vendosen për qëndrat komunitare por

për momentin është një që kryen këto shërbime.

6. Banorë: Problemi i varrezave në Lagjen e Re.

ZV/Kryetari: Jemi në djeni të këtij problemi dhe kemi diskutuar me kryetarin dhe kemi ngrit një grup pune për shpronësim sepse duhet të gjendet dhe zona ku do të zhvillohet kjo pjesë.

7. Banorë: Fshati Manzë.
   - Problemi i ujit të pijshëm.

8. Banore në Hamallaj.
   - Kërkesë individuale për banesat sociale, nënë e vetme me fëmijë të sëmurë. Përshëndetje jam një nënë që kam një fëmijë jetim dhe kam kërkuar shtëpi sociale të cilën nuk e kam përfituar sepse ma kane refuzuar për arsye qe nuk jam në mardhënie pune, une kam kërkuar punë në vendin ku jetoj dhe nuk ma kanë pranuar si sanitare pasi jane tre veta aktualisht, ndërkohë unë fëmijen e kam të sëmure me insulina dhe nuk mund të shkojë shumë larg pasi duhet të kujdesem për fëmijën e semurë. Ju kërkoj ndjes por kam ardh nga Kulla për këtë arsye.

ZV/Kryetari: Banesat sociale kanë një proçedurë ku mund të aplikosh dhe nuk mendoj që është refuzuar sepse nuk është hapur procedura ,por ka disa kritere dhe një prej të cilëve është pjesa e marredhënieve të punës dhe të ardhurave financiare të cilat vendosen sipas ligjit dhe ne duhet ta zbatojmë , ju nuk e keni perfituar për këtë arsye.

9. Banorë Fshati Rrotull, Draç, Shkafanë, kërkohen investime për:
   - furnizimin me ujë,
   - pastrimin
   - sistemimin e ujërave të zeza në zonën turistike .

Drejtori i drejtorisë së projekteve: Për pjesën e kanalizimeve të zonës së Gjirit të Lalëzit në djeninë time është bërë tenderimi i projektit për furnizimin me ujë të komplet pjesës së Fushë Drac deri në Shen Pjetër komplet zona e fushës , njëkohësisht ka përfunduar dhe rrjeti i kanalizimeve dhe në kontakt me UKD na është thënë që do tenderohen së shpejti dhe pjesa e kanalizimeve . besoj për vitin që vjen do tenderohet dhe ky objekt dhe do ti jepet fund problemeve të kësaj zone turistike në lidhje me kanalizimet dhe furnizimit me ujë .

**Rekomandimet për dëgjesat publike 2025-2027**

**Manzë dhe Ishëm.**

10. Fshati Shkallë- Manëz.
    - Zona jonë është zonë bujqësore,fshatarët shpenzojnë për të mbjellat, por në këtë zonë, nuk vjen fare uji për vaditje.
    - Ujë të pijshëm vjen më pak se 20 min në ditë.
    - Nuk pastrohet kanali në këtë zonë.
11. Tre rrugë që janë nisur janë lënë përgjysëm për 50-100m rrugë, Rruga ‘‘Fortuzi‘‘, Rruga ‘‘Djaloshi“, Rruga e Varrezave.
12. Fshati Shkallë ka vetëm 10min ujë të pijshëm në ditë.
13. Fshati Hamallaj
    - problem Rruga “Shehu”, nuk është një rrugë e mirëfilltë pasi është anash kanalit dhe përbën rrezik për banorët. Kërkohet të sistemohet rruga për të kaluar banorët qoftë dhe pa asfalt.
14. Rruga“Hoxha“, është e prishur dhe plot gropa, pengesë për investimet që janë bërë në këtë zonë.
15. Ishëm
    - Në fshatin Draç është emergjente ndërtimi i një Ambulance.
    - Nevojë për një qendër komunitare ose dicka që mund të sigurojë shërbime për fëmijët dhe gratë.
16. Problemi i varrezave në Lagjen e Re.
17. Fshati Manzë.
    - Problemi i ujit të pijshëm.
18. Hamallaj.
    - Kërkesë individuale për banesat sociale, nënë e vetme me fëmijë të sëmurë.
19. Fshati Rrotull, Draç, Shkafanë, kërkohen investime për:
    - furnizimin me ujë,
    - pastrimin
    - sistemimin e ujërave të zeza në zonën turistike .

**Dëgjesat Publike 2025-2027**

**Dëgjesa II**

Data 08.10.2024.

Vendi i takimit: Kompleksi "Bushmani", Sukth.

Ora: 10°°-14°°

Në këtë takim kishte një pjesmarrje të gjerë, ku të pranishëm ishin përfaqësues të komunitetit të Njësive Administrative Sukth dhe Katund i Ri, përfaqësues të grupeve të interesit, përfaqësues të Këshillit Bashkiak, Institucioneve Arsimore, OSHE, Emergjenca Civile, Ujësjellës-Kanalizime, OJF që operojne në këto Nj.A.

Pjesmarrës në takim, sipas listë prezencës, 102 persona.

Në takim u prezantuan këto programe:

- Arsimi Parashkollor dhe Parauniversitar. Investimet në arsim për PBA 2025-2027. (DAKRSKF)
- Infrastruktura rrugore &Transporti, investimet për PBA 2025-2027. (DPIP)
- Strehimi dhe Shërbimi Social, projektet e shërbimit Social për PBA 2025-2027. (DSHS)

Takimin e hapi ZV/Kryetari i Bashkisë Durrës, z. Elio Jani, Në fjalën e tij ai tha:
Përshëndetje të gjithëve. Sot jemi në ditën e dytë të zhvillimit të dëgjesave publike për buxhetin e vitit 2024 dhe PBA 2025-2027. Në këto dy Njësi Administrative, ne kemi përfunduar shume akse rrugore, kemi të tjera në proçes, të cilat do të na i prezantojë drejtori i drejtorisë së projekteve. Paralel me punën që ne bëjmë si Institucion, kemi një bashkëpunim të ngushtë me FSHZH, me të cilin kemi bërë shumë akse të rëndësishme, riparime, asfaltime, kuartalla ndertime shkollash etj.Në fund të prezantimit të tre programeve nga drejtorët, do të bashkëbisedojmë për të dëgjuar kërkesat dhe sugjerimet tuaja.
Më tej dëgjesa vazhdoi me prezantimin e tre programeve buxhetore për PBA 2025-2027, të cilët u prezantuan nga Drejtorët e Drejtorive përkatëse të Bashkisë Durrës.
U prezantuan investimet në infrastrukturë rrugore me Buxhetin e vitit 2024, ndërtimin e rrugëve të fshatit Kullë, Hamallaj Hidrovor, Rrugën Gjergj Meta Rrushkull dhe rrugët në lagjet 1-6 Vardardhë ndërsa në Njësinë e Katundit të ri Rrugën Vau Rrjasës, Lisakëve, Lëvizja e lirë-Domaj dhe rruga Vain. Përsa i përket infrastrukturës së sistemit të vaditjes dhe kullimit është realizuar projekti i rrjetit të kanalizimeve për fshatin Rrushkull. Prioritet në tre vitet e ardhshme do të ketë ndërtimi i fushës së sportit në Katund të Ri, krijimi i hapësirave të gjelbëra dhe këndeve të lojrave për fëmijë në hapësirat midis pallateve, në bashkëpunim me FSHZH, rikonstruksioni i Qëndrave Shëndetësore, do të fillojë dhe ndërtimi i shkollës në Vadardhë.
Pas prezantimit të këtyre programeve, fjalën e morën banorët dhe të pranishmit në sallë, të cilët diskutuan rreth këtyre prioriteteve, duke dhënë mendimet dhe duke parashtruar kërkesat dhe sugjerimet e tyre.

**Dëgjesa publike për Programin "Arsimi parashkollor dhe parauniversitar " dhe programi "Shërbimet Publike, Investimet në Arsim" PBA 2025-2027**

Më pas e mori fjalën Drejtori në Drejtorinë e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe komunitete Fetare, z. Adrian Gurra, i cili bëri prezantimin për programin "Arsimi parashkollor dhe parauniversitar dhe investimet në arsim" **për PBA 2024-2026.**

**Qëllimi i takimit:** Përthithja nëpërmjet Dëgjesave Publike, të mendimeve dhe sugjerimeve të aktorëve të ndryshëm të fushës për të realizuar një buxhet sa më pranë qytetarëve dhe nevojave të tyre. Përcaktimi i prioriteteve të investimeve në Arsim në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së infrastrukturës arsimore, duke ofruar shërbime eficente dhe cilësore për vitin në vazhdim 2023 dhe për projekt buxhetin afatmesëm 2025-2027.

**Prezantimi i Drejtorit të Arsimit, z. Adrian Gurra**

**z. Gurra**, bëri një analizë të detajuar mbi arsimin dhe objektivat e tij deri në vitin 2027,investimet e bëra nga Bashkia Durrës në vitin 2024, dhe cilat janë ato që do të kryhen për vitet 2025-2027.
Foli mbi strategjinë e programit të Arsimit parashkollor dhe atij parauniversitar për të gjithë institucionet arsimore në territorin e Bashkisë Durrës.



Ai u ndal në numrin e institucioneve të Arsimit parashkollor dhe atij parauniversitar që administron Bashkia Durrës dhe numrin e fëmijëve dhe nxënësve që frekuentojnë këto institucione.




z.Gurra foli per investimet e bëra nga Bashkia Durrës në vitin 2024, dhe cilat janë ato që do të kryhen për vitet 2025-2027.



## 1- Programi i Rindërtimit

### Ndertime te reja ne proçes

1. Shkolla Mesme Sportive "Benardina Qerraxhi ", Durrës/Nentor 2024
2. Konvikti I shkollës "Bernardina Qeraxhi", Durrës /Nentor 2024
3. Konvikti I vjetër I shkollës "Beqir Çela", Durrës/Janar 2025
4. Shkolla Mesme Bashkuar "Rexhep Mezini ", NJA Ishëm/Shkurt 2025
5. Shkolla e Mesme Manëz/ne pritje te tenderimit (Ndertim I ri, financim me fondet e Bashkisë Durrës, eshte ne faze vleresimi perfundimtar dhe brenda muajit Nentor 2024 fillon puna).
6. Shkolla 9 vjeçare "Vadardhë", NJA Sukth /ne proces hartimi specifikime teknike

### Rikonstruksionnë proçes

1. Shkolla 9 vjecare " Kushtrimi i Lirise ", Durrës/Me Vendim KSHR-je kalon ne programin e rindertimit me programin EU4Schools, zbatuar nga UNDP/project propozimet per konsultim publik
2. Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare "Riza Shera" Radë dhe Kopësht/perfunduar punimet, ne pritje te lidhjes se energjise elektrike dhe kolaudimit

## 2-Programi i dytë: Investime me fondet e veta të NJQV (Bashkisë Durrës)

VITI 2025-26

- Ndërtim shkolla 9 vjeçare "Met Hasa "/proces lidhje kontrate
- Ndërtim shkolle e re nga bashkimi i 2 shkollave 9 vjeçare: "Vasil Ziu" dhe "Nënë Tereza" /2026
- Ndertim I terreneve te mbyllura sportive ne shkollat 9 vjecare "Jusuf Puka" dhe "Abedin Dino"

VITI 2027

- Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare "Hamza Muca"
- Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare "Jubë"
- Rikonstruksion godina e shk 9 vj "Bishtkamëz"
- Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare "Pal Zefi", Rrushkull




Z. Gurra, referoi për të gjitha investimet e kryera në Institucionet Arsimore gjatë vitit 2024 duke u ndalur kryesisht për cdo investim të kryer në Njesine Administrative Sukth dhe Katundi i Ri. Fokusi kryesor i investimeve në arsim, ishte ai i procesit të rindërtimit si dhe nëinvestimet që parashikohen të behen në institucionet arsimore gjatë viteve 2025-2027.

## Objekte arsimore Nja Sukth

- Shkolla 9 vjeçare “Njazi Mastori”+ kopesht (Ndërtim I Ri me FSHZH/përfunduar 2021)
- Shkolla 9 vjeçare “Vadardhë”/proces hartimi specifikime teknike
- Shkolla 9 vjeçare “Hamallaj”,(Ndërtim i ri me fondet e Bashkisë Durrës/përfunduar 2020(oborr+rrethim rregullim 2023)
- Shkolla 9 vjeçare “CU Perlat” (Ndërtim I ri me FSHZH shkollë fillore dhe kopësht/përfunduar 2021)
- Shkolla MB “Ismet Nanushi” Kullë + Kopesht godine e vecante (Ndërtim I ri EU4Schools/përfunduar 2022)
- Shkolla e mesme “Dhosi Liperi” (Ndërtim i ri/përfunduar në mars 2023)

## Objekte arsimore NJA Katund i Ri

- MB Jusuf Hoti/Kat.RI (Rikonstruksion shkolla egzistuese dhe ndërtim i ri shkollë fillore dhe kopësht, programi CIS,bashkëfinancues me Bashkinë Durrës/inaguruar shtator 2024)
- Shkolla 9 vjeçare “ArtanZeka”,Qerret(Ndërtim i Ri/financuar Bashkia Durrës/Përfunduar 2020)
- Shkolla 9 vjeçare “Bisht Kamez” (Pritet vleresimi dhe planifikimi nga grupet teknike te Bashkise Durres)
- Shkolla 9 vjeçare “Bajram Gashi”, Fllakë (Rrethim + lyerje 2023-2024)
- Shkolla 9 vjeçare “Sukth Katund” (Sistem ngrohje, rrethim, kalçeto/Fondet e Bashkisë Durrës/2019)
- Shkolla 9 vjeçare “Fshat Rinia” (Ndërtim I Ri/Fondet e Bashkisë Durrës/Përf.vitin 2020)+rikonstruksion fushe sporti e mbuluar bashkefinancim me World Vision/ shtator 2023)
- Shkolla 9 vjeçare “Jubë” (Pritet vleresimi dhe planifikimi nga grupet teknike te Bashkise Durres)

**Foto nga Dëgjesa Publike për Programin "Arsimi parashkollor dhe parauniversitar " dhe programi "Shërbimet Publike, Investimet në Arsim" PBA 2025-2027 në Nj.Administrative Sukth dhe Katundi Ri**








**Dëgjesa Publike për Programin "Projektet e Shërbimit Social" PBA 2025-2027 Drejtoria e Shërbimit Social ne Nj. Administrative Sukth dhe Katundi Ri**

Më pas e mori fjalën Shef i Drejtorisë së Shërbimit Social Z. Arlind Vata, e cila bëri prezantimin e **"Projekteve të Shërbimit Social" për PBA 2025-2027.**

**Qëllimi i takimit:** Informimi i pjesëmarrësve me politikat e përmirësimit të kushteve për zhvillimin e sistemit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror në Bashkinë Durrës dhe përmirësimi i shërbimeve sociale në territorin e Bashkis Durrës për vitin në vazhdim 2024, dhe marrja e opinioneve të tyre për të përmirësuar shërbimet sociale dhe shërbimet e përkujdesit shoqëror për projekt buxhetin afatmesëm 2025-2027.

**Prezantimi i shefit të Drejtorisë së Shërbimit Social**

Shef i Drejtorisë së Shërbimit Social Z.Arlind Vata, gjatë prezantimit të projekteve të shërbimeve sociale, theksoi se Bashkia Durrës ka hartuar Planin e shërbimeve sociale 2021-2024, i cili është bazuar në qasjen e ofrimit të një pakete shërbimesh për të gjitha kategoritë e grupeve në nevojë si dhe në filozofinë e ndërtimit të partneritetit midis aktorëve të ndryshëm, si institucionet e qeverisjes vendore dhe rajonale, organizatat ndërkombëtare, kombëtare dhe ato lokale, si dhe biznesin vendor si një mbështetës potencial në fuqizimin e shërbimeve sociale. Dhe për vitin buxhetor 2025, do ti përmbahemi këtij plani.

Gjatë prezantimit, Z.Arlind Vata bëri një pasqyrë të situates aktuale, detyrat dhepërgjegjësitë e Pushtetit Vendor si dhe u ndal në shërbimet sociale që po kryhen në Bashkinë e Durrësit gjatë vitit 2024 dhe për vitet 2025-2027.

Z.Arlind Vata, theksoi se prioriteti që kemi pasur në Njësite tuaja Administrative, është t'ju ofrojmë një shërbim të menjëhershëm, duke rritur kapacitetet në burimet njerëzore, në trajnimin e stafit.

Në Njësinë Administrative Sukth, është Qendra e Shërbimeve Emergjente, ku shërbehen individë të moshës nga 2-21 vjec, dhe Bashkia ofron 60% të buxhetit. Shërbimi ofrohet jo vetëm për individët, por dhe për familjet. Gjithashtu ne punojmë dhe me programe ndërgjegjësimi për komunitetin.

Për Nj. Administrative Sukth, kemi projektin për ngritjen e shërbimeve sociale te integruaura, që është pjesë e programit: "Askush të mos mbetet pas". LNB, është një program i Përbashkët i Kombeve të Bashkuara dhe zbatohet nga Fondacioni "Ndihme për Fëmijët".Mbi 50 familje janë trajtuar me shërbime sipas nevojave specifike që kanë pasur, janë mbë shtetur me programin e rigjenerimit të të ardhurave 7 raste, 12 të rinjë janë orientuar për punësim dhe kurse formimi profesional.

## Qendra Komunitare për Fëmijë me Aftësi të Kufizuar

13

Qendra ofron shërbime që synojnë rehabilitimin dhe gjithëpërfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla dhe komunitet, nëpërmjet ndërhyrjes me trajtime të individualizuara, mbështetjes së familjes dhe ndërgjegjësimit komunitar.

1

**Shërbimet:**
**I.** Shërbim direkt për fëmijët me aftësi të kufizuara (2-21 vjeç) në fushën e sjelljes, komunikimit, autonomisë, aftësive akademike dhe motorikës.
**II.** Rritje e kapaciteteve të prindërve dhe familjarëve për të punuar me fëmijët në shtëpi dhe për të advokuar për gjithëpërfshirjen e tyre në arsim dhe komunitet.
**III.** Ndërgjegjësim i komunitetit për të mbështetur gjithëpërfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

**Totali përfitues:**
173 fëmijë dhe familjet e tyre

**Aktualisht përfitues**
82 fëmijë dhe familjet e tyre

**Financimi:**
Bashkia Durrës









1

## Qendra e shërbimeve me bazë komunitare Njësia Administrative Sukth

13

- Projekti: "Shërbimet e integruara sociale për zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të komuniteteve vulnerabël"- Faza II, është pjesë përbërëse e Programit LNB.
  Periudha e zbatimit: Janar 2022 – Korrik 2025 (43 muaj), por ne vitin 2024 buxhetohet nga Bashkia Durres. Ai zbatohet nga Fondacioni "Ndihmë për Fëmijët" (NPF) dhe Bashkisë Durrës nën menaxhimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të UNDP-së. Projekti po ndërton modelin e shërbimeve sociale të integruara për familjen, i cili synon fuqizimin e familjeve për të thyer rrethin vicioz të varfërisë. Punonjësit socialë të bashkisë do të angazhohen në ofrimin e shërbimeve duke synuar nevojat e familjes në tërësi dhe duke marrë parasysh dhe adresuar nevojat specifike, komplekse dhe afatgjata të secilit prej anëtarëve të familjes. Bashkitë do të krijojnë modelin e ri të ofrimit të shërbimeve sociale të integruara brenda bashkisë dhe do të forcojnë kapacitetet dhe ekspertizën e tyre për të ofruar, mbështetur dhe zgjeruar këtë modeMbi 50 familje janë trajtuar me shërbime sipas nevojave specifike që kanë pasur, janë mbështetur me programin e rigjenerimit të të ardhurave 7 raste, 12 të rinjë janë orientuar për punësim dhe kurse formimi profesional.
- Financimi : Bashkia dhe PNUD

10/25/2023

**Foto nga Dëgjesa Publike për Programin "Projektet e Shërbimit Social" PBA 2025-2027 në Sukth dhe Katundi Ri**









**Dëgjesa Publike e Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publik për PBA 2025-2027 në Nj. A Sukth dhe Katundi Ri**

Më pas e mori fjalën Drejtori i Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike , Z.Lorenc Facja, i cili bëri prezantimin e Programit të Projekteve dhe Investimeve të Infrastrukturës Publike për PBA 2025-2027.

**Prezantimi i specialistit të Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike** .

Drejtori i Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike , Z.Lorenc Facja, u bëri të ditur pjesëmarrësve se këto takime po bëhen në kuadër të realizimit të dëgjesave publike për të bërë të mundur më pas përgatitjen e Buxhetit Afatmesëm 2025-2027 lidhur me investimet në infrastrukturën rrugore dhe shërbimet publike.

Qëllimi i programit: Përthithja nëpërmjet dëgjesave të mendimit të aktorëve të ndryshëm të fushës për të realizuar një buxhet sa më pranë qytetarëve dhe nevojave të tyre.

Përcaktimi i prioriteteve të investimeve në infrastrukturë në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë duke ofruar shërbime eficente dhe cilësore.

Z.Lorenc Facja, informoi të pranishmit lidhur me programin e **"Infrastrukturës rrugore dhe Transportit Publik"**, duke u përqëndruar kryesisht në informimin e pjesëmarrësve mbi investimet e kryera gjatë vitit 2024, në Njësitë Administrative Sukth dhe Katundi Ri dhe parashikimi për investimet në infrastrukturën rrugore për këto Njësi Administrative gjatë tre viteve në vazhdim 2025-2027.
Z.Lorenc Facja, theksoi se:

- Do shqyrtojmë të gjitha kërkesat tuaja,
- Do bëjmë rilevimin topografik të zonës suaj
- Do marrim në konsideratë shqetësimin që keni paraqitur.
- Përzgjedhja e rrugëve ku do të investohet, është bërë në bashkëpunim të ngushtë me stafin e Njësive Administrative, gjithashtu duke pasur parasysh dhe kërkesat e banorëvetë zonës për problematika të ndryshme.

Ne kemi një listë të gjatë për investimet e rrugëve dhe disa shkollave. Buxheti parashikohet për 3 vjet. Çdo vit bëhen rishikime në buxhet. Njësia juaj është një zonë me shtrirje të madhe, prandaj ne nuk mund ti bëjmë të gjitha.
Gjatë prezantimit, Z.Lorenc Facja, bëri me dije se investimet e kryera nga Bashkia Durrës për vitin 2024 për Nj. Administrative Sukth dhe Katund i Ri janë:

## 1. INFRASTRUKTURE RRUGORE TE REALIZUAR NE VITIN 2024

### NJ.A. SUKTH

Rrug ne pllatet Sukth 1450ml

Rruga ne Hamallaj Sektor2500ml

Total 3950 ml

### NJ.A. KATUND I RI

Rruga Gjyzeli, Bega, Qendra Shendetesore 790 ml

Rruga Vau i Grave 820 ml

Total 1610 ml










## 2. PASTRIM KANALESH DHE ARGJINATURA TE REALIZUAR

### SUKTH

Kanal kullues 8110ml

Argjinatura 2850 ml

### KATUND I RI

Kanal kullues 1730ml

Argjinatura 700 ml









# 3. OBJEKTIVAT PER VITIN 2025-2027

PROJEKTE NE INFRASTRUKTURE RRUGORE

1. SUKTH

-Rruget e fshatit Kulle

-Rruget e fshatit Hamallaj Hidrovor

-Rruga Gjergj Meta Rrushkull

-Rruget ne lagjen 1-6 Vardardhe

2.KATUND I RI

- Rruga Vau Rrjaes
- Rruga Lisakeve
- Rruga Levizja e Lire - Domaj
- Rruga Vain

3.PROJEKTE NE INFRASTRUKTUREN PUBLIKE

-Nderim i fushes se sportit Katund i Ri

-Nderim i rrjetit te kanalizimeve ne Fshatin Rrushkull Nj.A. Sukth

-Rikonstruksion dhe ndertim i qendrave shendetesore

-Rikonstruksion dhe ndertim te kopeshteve/çerdheve

-Krijimin e hapsirave publike dhe kende lodrash per femijesh

-Rigjenerim Fasadash ne Pallatet e Sukthit






**Foto nga Dëgjesa Publike për programin e "Infrastrukturës rrugore dhe Transportit Publik", për PBA 2025-2027 në Nj.Administrative Sukth dhe Katundi Ri**





Pyetje dhe Diskutime

**Sukth dhe Katund i Ri**

Diskutime

1. Banore e Sukthit

Jam një banore e Sukthit, kam aplikuar për banesë sociale, sepse jam e pastrehë, dhe nuk kam marrë asnje pergjigje nga bashkia.

ZV/Kryetari - Nuk eshte se nuk ta kane dhene nje pergjigje, aplikimet jane te hapura ne Bashki per banesat sociale, por bashkia nuk ka hapur thirrje per banesa sociale me qera, sepse nuk ka banesa ne dispozicion, kur Bashkia ti kete keto banesa ne dispozicion do hapi thirrje dhe do shqyrtoje aplikimet.

2. Kryeplak i fshatit Fllake

- Rruga presim qe te shtrohet.
- Ne fshatin Fllake shumica e ndertesave jane te pa legalizuara. Kerkojme te legalizohen.

ZV/Kryetari - Bashkia nuk ka target ligjor per te bere legalizimet. Ne kemi marreveshje me ASHK per procesin e legalizimeve, per qytetaret qe kane bere aplikim, kemi krijuar grup pune qe te kryeje matjet, pasi qytetari ka bere aplikimin.

3. Kryeplak I Katundit te Ri

- Rruga e lagjes me te vjeter te K.Ri eshte akoma e parregulluar. Sot nga prezantimi e degjova qe eshte planifikuar per rregullim.
- Une kerkoj te behet nje plan per dy kanalet e rruges qe te behen me trotuar, mos te dalin ujrat e zeza te pakten ne segmentin para shkolles.
- Njesia Bashkiake qe ka qene eshte prishur duhet te rregullohet.

Drejtori i Drejtorisë Projekteve:

- Për rrugën, kemi aplikuar tek FSHZH.
- Për kanalet, që të bëhen me trotuar, nuk është parashikuar, në projekt, është parashikuar vetëm asfaltimi.
- Për rikonstruksionin e njësisë administrative, është parashikuar ne buxhetin 2025-2027, projekti është gati dhe presim të tenderohet, do të fillojë së shpejti.

4. Kryeplak i fshatit Vadardhë.

    - Qendra shëndetësore në kushte shumë të vështira, krahas lagështirës, tavani me kallama i rrënuar, nuk ka krevat për të bërë vizitat, të shtohen dhoma për të sëmurët pasi dhe Ambulanca në Hidrovor është jashtë kushteve.
    - Mungon ndriçimi i rrugëve, rrugët janë të prishura dhe koshat e plehrave mungojnë.
    - Rruga jashtë shkollës në Vadardhë është e prishur, dhe fëmijët në kohë të keqe nuk kalojnë dot.
    - Rruga kryesore është dëmtuar, kanalet e ujërave të zeza derdhen në rrugë, gjithë zona është e mbushur me mbeturina.
    - Ndërtimit të shkollës nuk i është dhënë zgjidhje akoma.
    - Lagjet 1, 2, 5, 6, Sukth i Ri në Vadardhë kanë nevojë për ndërhyrje pasi mungon rruga, ndriçimi, pastrimi i kanaleve, mungojnë trotuaret, Lagja 5 ka problem shtyllat elektrike pasi janë në rënie dhe telat rrezikojnë jetën e fëmijëve dhe banorëve.

5. Drejtor i Qendres Shëndetësore Vadardhë.

- Kemi marrë mbështetje nga Kryetarja e Bashkisë, për rikonstruksionin e Qendrës Shëndetësore. E mira do ishte të bëhet ndërtim i ri, dhe të shtohen dhomat. Edhe ambulanca që kemi në Hidrovor, është jashtë kushteve.

6. Infermiere në Vadardhë.

- Flas dhe si infermiere, dhe si banore e Vadardhës. Kushtet në Qendrën Shëndetësore, janë shumë të këqija, po kështu rrugët, ndriçimi i zonës, tërheqja e mbeturinave.

Drejtori i Drejtorise së projekteve:

- Do merremi me projektin e Qendrës Shëndetësore, dhe do jemi në bashkëpunim.
- Do të marrim në konsideratë të gjitha vërejtjet tuaja, dhe do të veprojmë me ndërmarrjet tona të varesisë.

7. Fshati Kullë
   - Kanalizimet e ujërave të zeza janë emergjente, ndriçimi i rrugëve mungon, dhe nuk ka hapësira për argëtimin e fëmijëve.
   - Është premtuar 10m zgara mbrapa shkollës, pasi është problem në kalimin e nxënësve.
   - Kërkohet shtrimi i trotuarit në pjesën ngjitur me shkollën, koshat e plehrave janë ngjitur me shkollën dhe duhet të sistemohen dhe caktohet nje vend tjetër.

8. Fshati Perlat
   - Varrezat janë mbushur me mbeturina dhe nuk ka vend të vendosen të vdekurit.
   - Nje pjesë e Rrushkullit po përmbytet nga uji, është çarë tubi i ujit, dhe askush nuk vjen.

Drejtori i Drejtorisë së projekteve:

- Është shtypur tubi i ujit, kemi komunikuar me Ujësjellësin dhe do të merren masa.
- Për varrezat, është ngritur grup pune për shpronësimin, po mundohemi të gjejmë sipërfaqe toke për të ndërtuar varrezat e reja.

9. Banor i fshatit Rrushkull.
   - Rruga me gropa, përbën problem për banorët dhe pjesa e sistemimit të kanalizimeve. Kanalizimet e pasistemuara, kanë shpërthyer nëpër rrugë dhe banorët kanë vështirësi për të dalë nga shtëpia. Tubat e kanalizimeve kanë 3-4 muaj që janë sjellë por akoma nuk ka filluar puna.
   - Në varreza nuk është e mundur kalimi pasi janë hedhur mbeturina dhe rrjellin ujërat e zeza, duhet mirëmbajtje dhe roje.

Drejtori i Drejtorise së projekteve:

- Ne i kemi parë nga afër të gjitha problematikat tuaja. Në fillim, po punojmë për të përfunduar rrjetin e kanalizimeve, pastaj do të fillojmë me rregullimin e rrugëve.
-

10. Banor i fshatit Rrushkull.
- Problem kemi rrugën.

11. Kryeplaku i fshatit Rrushkull.
- Jemi i vetmi fshat, ku nuk është vënë dorë fare, pa asnjë metër trotuar.
- Fondi i Zhvillimit, ka sjellë tubat, kanë punuar 3-4 muaj dhe punimet kanë mbetur.

12. Mësuese e shkollës “Pal Zefi”, në Rrushkull.
- Mungon ngrohja në shkollë.
- Mungon një ambjent sportiv.

Drejtor i Drejtorisë së Arsimit:
- Do e marrim në konsideratë.

13. Banore e fshatit Rrushkull.
- Problem rruga, kanalizimet, kanë shpërthyer ujrat e zeza.
- Problem pastërtia në varreza, nuk kalohet dot nga plehrat, duhet një roje.

14. Banor fshati Vadardhë.
- Projekti për shkollën e Vadardhës?
- Lagjet 1,2,5,6 presin për ndërhyrje në rrugë, ndriçim, pastrim kanalesh.
- Ka mungesë trotuaresh.
- Duam dokumentat e pronësise.

15. Drejtor i shkollës Kullë.
- Na është premtuar që do të vendosen zgara rreth 10m, për të kaluar nxënësit.
- Na është premtuar shtrimi i pjesës së trotuarit ngjitur me shkollën.
- Kazanet e mbeturinave nuk janë vendosur në vend të përshtatshëm, nqs ka mundësi, të largohen dhe të vendosen në një vend tjetër.
- Rruga “Kace”

**Rekomandimet për dëgjesat publike 2025-2027**

**Sukth dhe Katund i Ri**

1. Vadardhë
    - Qendra shëndetësore në kushte shumë të vështira, krahas lagështirës, tavani me kallama i rrënuar, nuk ka krevat për të bërë vizitat, të shtohen dhoma për të sëmurët pasi dhe Ambulanca në Hidrovor është jashtë kushteve.
    - Mungon ndriçimi i rrugëve, rrugët janë të prishura dhe koshat e plehrave mungojnë.
    - Rruga jashtë shkollës në Vadardhë është e prishur dhe fëmijët në kohë të keqe nuk kalojnë dot.

- Rruga kryesore është dëmtuar, kanalet e ujërave të zeza derdhen në rrugë, gjithë zona është e mbushur me mbeturina.
- Ndërtimit të shkollës nuk i është dhënë zgjidhje akoma.
- Lagjet 1, 2, 5, 6, Sukth i Ri në Vadardhë kanë nevojë për ndërhyrje pasi mungon rruga, ndriçimi, pastrimi i kanaleve, mungojnë trotuaret, Lagja 5 ka problem shtyllat elektrike pasi janë në rënie dhe telat rrezikojnë jetën e fëmijëve dhe banorëve.

2. Fshati Kullë
    - Kanalizimet e ujërave të zeza është emergjente, ndriçimi i rrugëve mungon dhe nuk ka hapësira për argëtimin e fëmijëve.
    - Është premtuar 10m zgara mbrapa shkollës pasi është problem në kalimin e nxenësve
    - Kërkohet shtrimi i trotuarit në pjesën ngjitur me shkollën, koshat e plehrave janë ngjitur me shkollën dhe duhet të sistemohen dhe caktohet nje vend tjetër.
3. Fshati Perlat
    - Varrezat janë mbushur me mbeturina dhe nuk ka vend të vendosen të vdekurit.
4. Fshati Rrushkull
    - Rruga me gropa përbën problem për banorët dhe pjesa e sistemimit të kanalizimeve. Kanalizimet e pasistemuara kanë shpërthyer nëpër rrugë dhe banorët kanë vështirësi për të dalë nga shtëpia. Tubat e kanalizimeve kanë 3-4 muaj që janë sjellë por akoma nuk ka filluar puna.
    - Në varreza nuk është e mundur kalimi pasi janë hedhur mbeturina dhe rrjellin ujërat e zeza, duhet mirëmbajtje dhe roje.
    - Shkolla“Pal Zefi“, mungon sistemi i ngrohjes dhe ambientet sportive në shkollë.
    - Mungon qoftë dhe një metër trotuar.
5. Sukth
    - Të mundësohen banesat sociale sipas aplikimeve të bëra.
    - Njësia administrative është akoma e prishur dhe nuk është rregulluar.
    - Rruga “Kaca” të shtrohet pasi është e pakalueshme.
6. Katund i Ri
    - Rruga e lagjes më të vjetër në Katund të Ri është e parregulluar, dy kanalet e rrugës të bëhen me trotuar
    - Sistemimi i ujërave të zeza në segmentin para shkollës.
7. Fllakë
    - Një pjesë e konsiderueshme e banesave janë të palegalizuara.

## Dëgjesat Publike 2025-2027

**Dëgjesa III**

Data 09.10.2024.

Vendi i takimit: Kompleksi "Mergimi", Rrashbull.

Ora: 10°°-14°°

Në këtë takim kishte një pjesmarrje të gjerë, ku të pranishëm ishin përfaqësues të komunitetit të Njësisë Administrative Rashbull, përfaqësues të grupeve të interesit, përfaqësues të Këshillit Bashkiak, Institucioneve Arsimore, OSHE, Emergjenca Civile, Ujësjellës-Kanalizime, OJF që operojne në këtë Nj.A.

Pjesmarrës në takim, sipas listë prezencës, 70 persona.

Takimin e hapi N/Kryetari i Bashkisë, Z. Elio Jani. Në fjalën e tij ai tha:

Përshëndetje të gjithëve. Sot jemi në ditën e tretë të zhvillimit të dëgjesave publike për buxhetin e vitit 2024 dhe PBA 2025-2027. Sot do të bëjmë një panoramë të investimeve që janë bërë në Njësinë Admnistrative Rrashbull, gjithashtu do tju prezantojmë dhe projektet e reja që do të zbatohen përgjatë harkut kohor 2025-2027. Në fund të prezantimit të të tre programeve nga drejtorët, do të bashkëbisedojmë për të dëgjuar kërkesat dhe sugjerimet tuaja.

Më tej dëgjesa vazhdoi me prezantimin e tre programeve buxhetore për PBA 2025-2027, të cilët u prezantuan nga Drejtorët e Drejtorive përkatëse të Bashkisë Durrës.

U prezantuan objektivat për investimet në infrastrukturë rrugore në Projekt Buxhetin e vitit 2025-2027, ndërtimin e 13 rrugëve në Njësinë Administrative Rrashbull me gjatësi 3'975m, ndërsa projektet në infrastrukturën publike për vitin 2025-2027, përfshijnë rikonstruksionin dhe ndërtimin e qendrave shëndetësore, rikonstruksion dhe ndërtimin e kopshteve dhe çerdheve, krijimin e hapësirave publike si dhe kënde lojërash për fëmijë, ndërtimin e tregjeve të produkteve bujqësore përgjatë rrugës së Ndroqit, ndërtimin e terreneve sportive si dhe pastrimin dhe rehabilitimin e sistemit të kullimit dhe vaditjes të cilat do të jenë prioritet për vitet e ardhshme.

Pas prezantimit të këtyre programeve, fjalën e morën banorët dhe të pranishmit në sallë, të cilët diskutuan rreth këtyre prioriteteve, duke dhënë mendimet dhe duke parashtruar kërkesat dhe sugjerimet e tyre.

### Dëgjesa publike për Programin "Arsimi parashkollor dhe parauniversitar " dhe programi "Shërbimet Publike, Investimet në Arsim" PBA 2025-2027 në Nj. Administrative Rrashbull

Më pas e mori fjalën Drejtori në Drejtorinë e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe komunitete Fetare, Z. Adrian Gurra, i cili bëri prezantimin për programin "Arsimi parashkollor dhe parauniversitar dhe investimet në arsim" **për PBA 2025-2027.**

**Qëllimi i takimit:** Përthithja nëpërmjet Dëgjesave Publike, të mendimeve dhe sugjerimeve të aktorëve të ndryshëm të fushës për të realizuar një buxhet sa më pranë qytetarëve dhe nevojave të tyre. Përcaktimi i prioriteteve të investimeve në Arsim në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së infrastrukturës arsimore, duke ofruar shërbime eficente dhe cilësore për vitin në vazhdim 2024 dhe për projekt buxhetin afatmesëm 2025- 2027.

**Prezantimi i  Drejtorit të Arsimit, Z. Adrian Gurra**

**Z. Gurra** e filloi prezantimin mbi qëllimin e dëgjesës dhe sa i rëndësishëm është fakti që së bashku ne diskutojmë mbi politikat që ka ndjekur Bashkia deri më sot dhe cilat janë ato deri në vitin 2027, duke bërë të qartë për të pranishmit se kush janë politikat tona dhe objektivat për këto vite dhe sesi mendojmë ne që nga diskutimet e përbashkëta të vendosim sa më mirë dhe drejt për prioritetet në fushën e arsimit, kulturës dhe sportit.

Z. Gurra, bëri një analizë të detajuar mbi arsimin dhe objektivat e tij deri në vitin 2027, investimet e bëra nga Bashkia Durrës në vitin 2023, dhe cilat janë ato që do të kryhen për vitet 2025-2027.

z. Gurra, referoi për të gjitha investimet e kryera në Institucionet Arsimore gjatë vitit 2024 duke u ndalur kryesisht për cdo investim të kryer në  Njesine Administrative Rrashbull. Fokusi kryesor i investimeve në arsim, ishte ai i procesit të rindërtimit si dhe në investimet qëparashikohen të bëhen në institucionet arsimore gjatë viteve 2025-2027.



## 1. Përmirësimi i infrastrukturës

- Përmirësimi i infrastrukturës në Bashkinë e Durrësit kryhet nëpërmjet dy programeve që nga tërmeti i 26 Nëntorit 2019 :

**1-Programit të Rindërtimit**

**2-Programit te investimeve me fondet e veta të NJQV (Bashkisë Durrës)**

**Programi i Rindërtimit**

Bashkia Durrës ka në proces rindërtimi 38 objekte, nga të cilat 30 kanë përfunduar dhe 8 janë në proces si më poshtë:

- 30 objekte te perfunduara (22 ndertime te reja/8 rikonstruksione)
- 8 objekte në proces (6 ndertime te reja/2 rikonstruksion)

**Financimet e procesit të rindërtimit të ndara sipas donatorëve**

- 13 objekte FShZh
- 18 objekte UNDP(EU4Schools) financim BE
- 1 objekt KFW gjermane financim qeveria gjermane
- 4 objekte CIS (Community Infrastructure Support) Danimark + Mbretëri e Bashkuar
- 2 objekte me financim nga të ardhurat e veta të Bashkise Durres

## 1- Programi i Rindërtimit

### Ndertime te reja ne proçes

1. Shkolla Mesme Sportive "Benardina Qerraxhi ", Durrës/Nentor 2024
2. Konvikti I shkollës "Bernardina Qeraxhi", Durrës /Nentor 2024
3. Konvikti I vjetër I shkollës "Beqir Çela", Durrës/Janar 2025
4. Shkolla Mesme Bashkuar "Rexhep Mezini ", NJA Ishëm/Shkurt 2025
5. Shkolla e Mesme Manëz/ne pritje te tenderimit (Ndertim I ri, financim me fondet e Bashkisë Durrës, eshte ne faze vleresimi perfundimtar dhe brenda muajit Nentor 2024 fillon puna).
6. Shkolla 9 vjeçare "Vadardhë", NJA Sukth /ne proces hartimi specifikime teknike

### Rikonstruksionnë proçes

1. Shkolla 9 vjecare " Kushtrimi i Lirise ", Durrës/Me Vendim KSHR-je kalon ne programin e rindertimit me programin EU4Schools, zbatuar nga UNDP/project propozimet per konsultim publik
2. Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare "Riza Shera" Radë dhe Kopësht/perfunduar punimet, ne pritje te lidhjes se energjise elektrike dhe kolaudimit

## Objekte te perfunduara brenda vitit 2024, nga programi i rindertimit

- Ne vitin 2024 kanë përfunduar dhe kane nisur procesin mesimor:
- Shkolla 9 vjeçare "Eftali Koci", Durrës / mars 2024
- Shkolla 9 vjeçare "14 Nëntori", Durrës / shtator 2024
- Shkolla e Mesme e Bashkuar "Jusuf Hoti"+ kopësht dhe shkollë fillore / shtator 2024
- Gjimnazi "Naim Frashëri",Durrës / shtator 2024
- Kopshti i shkolles 9 vjecare "Isuf Ferra", Nishtulla, Durrës/shtator 2024
- Palestra shkollës 9 vjeçare "Isuf Ferra", Nishtulla, Durrës /shtator 2024

## 2-Programi i dytë: Investime me fondet e veta të NJQV (Bashkisë Durrës)

VITI 2025-26

- Ndërtim shkolla 9 vjeçare "Met Hasa "/proces lidhje kontrate
- Ndërtim shkolle e re nga bashkimi i 2 shkollave 9 vjeçare: "Vasil Ziu" dhe "Nënë Tereza" /2026
- Ndertim I terreneve te mbyllura sportive ne shkollat 9 vjecare "Jusuf Puka" dhe "Abedin Dino"

VITI 2027

- Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare "Hamza Muca"
- Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare "Jubë"
- Rikonstruksion godina e shk 9 vj "Bishtkamëz"
- Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare "Pal Zefi", Rrushkull

## Objekte te perfunduara brenda vitit 2024, nga program me fonde te Bashkise Durres

VITI 2024

- Rikonstruksion shkolla MB "Besnik Hidri", Shënvlash/perfunduar Janar 2024
- Rikonstruksion Qendra Kulturore e Fëmijëve/perfunduar Qershor 2024
- Rikonstruksion gjimnazi "Dom Nikoll Kaçorri“/perfunduar Shtator 2024
- Ndërtim terreni sportiv i mbuluar multifunksional ne bashkefinancim me World Vizion ne shkollen e Re, Kenete (drejt perfundimit)
- Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare "Demokracia“/perfundon ne nentor 2024
- Ndertim kabine elektrike dhe pajisjeje per shkollat “Naim Frasheri” dhe “Benardina Qerraxhi”

## Objekte arsimore Nj.A. Rrashbull

- Shkolla 9 vjeçare “Vëllezërit Haradinaj”, Rrashbull (Ndërtim I ri/program I rindërtimit dhjetor 2020/FSHZH)
- Shkolla 9 vjeçare “Myslym Hidaj”, Arapaj (Ndërtim i ri me fondet e Bashkisë Durrës/përfunduar në vitin 2018+lyerje, izolim dritare, eleminim lageshtie nga palestra,lyerje kopshti/shtator 2024)
- Shkolla 9 vjeçare “Shefqet Ndroqi”, Romanat (Pritet vleresimi dhe planifikimi nga grupet teknike te Bashkise Durres)
- Shkolla 9 vjeçare “Hamza Muca”, Shkallnur (Pritet vleresimi dhe planifikimi nga grupet teknike te Bashkise Durres)
- Shkolla 9 vjeçare “Bilal Golemi” Stacioni Zooteknik Xhafzotaj (ndertim viti 2013 me fondet e bashkise /Sistemi I ngrohjes/2020)
- MB “Besnik Hidri” Shënvlash (Rikonstruksion total me fondet e Bashkisë Durrës/perfunduar janar 2024)

**Foto nga Dëgjesa Publike për Programin “Arsimi parashkollor dhe parauniversitar ” dhe programi “Shërbimet Publike, Investimet në Arsim” PBA 2025-2027 në Nj.Administrative Rrashbull**





**Dëgjesa Publike e Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publik për PBA 2025-2027 në Nj. A Rrashbull**

Më pas e mori fjalën Drejtori i Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike , z. Lorenc Facja, i cili bëri prezantimin e Programit të Projekteve dhe Investimeve të Infrastrukturës Publike për PBA 2025-2027.

**Prezantimi i drejtorit të Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike** .

Drejtori i Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike , z.Lorenc Facja, u bëri të ditur pjesëmarrësve se këto takime po bëhen në kuadër të realizimit të dëgjesave publike për të bërë të mundur më pas përgatitjen e Buxhetit Afatmesëm 2025-2027 lidhur me investimet në infrastrukturën rrugore dhe shërbimet publike.

**Qëllimi i programit**: Përthithja nëpërmjet dëgjesave të mendimit të aktorëve të ndryshëm të fushës për të realizuar një buxhet sa më pranë qytetarëve dhe nevojave të tyre.

Percaktimi i prioriteteve të investimeve në infrastrukturë në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë duke ofruar shërbime eficente dhe cilësore.

z.Facja, informoi të pranishmit lidhur me programin e **“Infrastrukturës rrugore dhe Transportit Publik”**, duke u përqëndruar kryesisht në informimin e pjesëmarrësve mbi investimet e kryera gjatë vitit 2024, në Njësinë Administrative Rrashbull, dhe parashikimi për investimet në infrastrukturën rrugore për këte Njësi Administrative gjatë tre viteve në vazhdim 2025-2027.
z.Facja, theksoi se: Me fondet e Bashkisë, ne cdo vit kemi një buxhet 20-30 milion lekë të reja, për cdo Njësi Administrative, të cilat i vëmë në shfrytëzim, në bazë të nevojave që ka komuniteti, duke vendosur prioritete se cili nga projektet do të realizohet më parë.
Përzgjedhja e rrugëve ku do të investohet, është bërë në bashkëpunim të ngushtë me stafin e Njësisë Administrative, gjithashtu duke pasur parasysh dhe kërkesat e banorëve të zonës për problematika të ndryshme.
Gjatë prezantimit, z. L.Facja, bëri me dije se investimet e kryera nga Bashkia Durrës për vitin 2024 për Nj. Administrative të Rrashbullit dhe projektet per vitet 2025-2027 si më poshtë vijon:

# 1. INFRASTRUKTURE RRUGORE TE REALIZUAR NE VITIN 2024

## NJ.A. RRASHBULL

Rruga Elez Isufi 550ml

Rruga Medar Shtylla 330ml

Rruga Baeleta 380ml

Rruga Andon Verdha 680ml

Total 1940 ml






# 2. PASTRIM KANALESH DHE ARGJINATURA TE REALIZUAR

Kanal kullues 9060ml





# 3. OBJEKTIVAT PER VITIN 2025-2027

## PROJEKTE NE INFRASTRUKTURE RRUGORE NE VITIN 2025

| NR | RAJONI | EMERTIMI RRUGA | GJATESIA ml | GJERESIA ml | SIPERFAQE m2 |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Nj.A. Rrashbull | BARLETA | 400 | 3.0 | 1,200 |
| 2 | Nj.A. Rrashbull | GJONVE | 400 | 3.0 | 1,200 |
| 3 | Nj.A.Rrashbull | BLETAJ | 210 | 3.0 | 630 |
| 4 | Nj.A.Rrashbull | SHABAJ | 400 | 3.0 | 1,200 |
| 5 | Nj.A.Rrashbull | LUCIE MILOTI | 140 | 3.0 | 420 |
| 6 | Nj.A.Rrashbull | GJON BUZUKU | 450 | 3.5 | 1,575 |
| 7 | Nj.A.Rrashbull | HOXHEVE | 850 | 4.0 | 3,400 |
| 8 | Nj.A.Rrashbull | ZANAVE | 180 | 3.0 | 540 |
| 9 | Nj.A.Rrashbull | TABAKU | 495 | 3.0 | 1,485 |
| 10 | Nj.A.Rrashbull | BAJRAM CURRI | 390 | 3.0 | 1,170 |
| 11 | Nj.A.Rrashbull | PARTIZANI | 610 | 3.0 | 1,830 |
| 12 | Nj.A.Rrashbull | TROPLINEVE | 1,000 | 3.5 | 3,500 |
| 13 | Nj.A.Rrashbull | SAMI FRASHERI | 240 | 3.5 | 840 |
| | TOTAL | | 3,975 | | 13,500 |

PROJEKTE NE INFRASTRUKTURE PUBLIKE 2025 -2027

-Rikonstruksion dhe ndertim i qendrave shendetesore

-Rikonstruksion dhe ndertim te kopeshteve/çerdheve

-Krijimin e hapsirave publike dhe kende lodrash per femije

-Nderim i tregjeve te produkteve buqesore ne pergjate rruges se Ndroqit

-Ndertimin e terreneve sportive

-Pastrim dhe rehabilitim te sistemit te kullimit dhe vaditjes





**Foto nga Dëgjesa Publike për programin e "Infrastrukturës rrugore dhe Transportit Publik", për PBA 2025-2027 në Nj.Administrative Rrashbull**









**Dëgjesa Publike për Programin "Projektet e Shërbimit Social" PBA 2025-2027**
**Drejtoria e Shërbimit Social në Nj. Administrative Rrashbull**

Më pas e mori fjalën Shefi i Drejtorisë së Shërbimit Social Z. Arlind Vata, i cili bëri prezantimin e **"Projekteve të Shërbimit Social" për PBA 2025-2027.**

**Qëllimi i takimit:** Informimi i pjesëmarrësve me politikat e përmirësimit të kushteve për zhvillimin e sistemit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror në Bashkinë Durrës dhe përmirësimi i shërbimeve sociale në territorin e Bashkis Durrës për vitin në vazhdim 2024, dhe marrja e opinioneve të tyre për të përmirësuar shërbimet sociale dhe shërbimet e përkujdesit shoqëror për projekt buxhetin afatmesëm 2025-2027.

**Prezantimi i shefit të Drejtorisë së Shërbimit Social**

Shefi i Drejtorisë së Shërbimit Social Z. Arlind Vata ferraj, u bëri të ditur pjesëmarrësvese këto takime po bëhen në kuadër të realizimit  të dëgjesave publike për të bërë të mundur më pas përgatitjen e Buxhetit Afatmesëm 2025-2027 lidhur me projektet e Shërbimit Social.

Z. Arlind Vata, theksoi se Bashkia Durrës ka hartuar Planin e shërbimeve sociale, i cili është bazuar në qasjen e ofrimit të një pakete shërbimesh për të gjitha kategoritë e grupeve në nevojë si dhe në filozofinë e ndërtimit të partneritetit midis aktorëve të ndryshëm, si institucionet e qeverisjes vendore dhe rajonale,  organizatat ndërkombëtare, kombëtare dhe ato lokale, si dhe biznesin vendor si një mbështetës potencial në fuqizimin e shërbimeve sociale.

Gjatë prezantimit, Z. Arlind Vata bëri një pasqyrë të situates aktuale, detyrat dhe përgjegjësitë e Pushtetit Vendor si dhe u ndal në shërbimet sociale që po kryhen në Bashkinë e Durrësit gjatë vitit 2024 dhe për vitet 2025-2027


Shërbimet
Qendra Komunitare Multifunksionale - Nishtulla, (financohet totalisht nga Bashkia)
Qendra Komunitare e Fëmijëve me aftësi të kufizuar (financohet totalisht nga Bashkia)
Qendra Ditore për të Moshuarit (financohet totalisht nga Bashkia)


Shërbimet
Qendra e Emergjencës(Bashkia+ Ëorld Vison+ Fondi Social)
Qendra Komunitare Multifunksionale Rrashbull
Shtepia eFoshnjes Durres ofron sherbim rezidencial dhe ditor (financohetnga fondet e Ministria eShendetesise)

Bashkia e Durrësit, vitet e fundit, ka shtuar llojin dhe shtrirjen në territor të shërbimeve të kujdesit shoqëror, në të cilin kemi përfshirë persona të moshës së tretë, personat me aftësi të kufizuar, fëmijët të cilët ndodhen në një situatë rreziku, viktima të dhunës në familje, viktima të trafikimit të qenjeve njerëzore.

Qëllimi i ofrimit të shërbimeve, është që ti garantojmë mbrojtje, integrim dhe përfshirje, të gjithë këtyre grupeve apo individëve. Për komunitetin Rom dhe Egjiptian, ne kemi pasur dhe një plan veprimi.
Z. Vata, përmendi shërbimet sociale në Bashkinë e Durrësit si dhe Qendrat që ofrojnë keto sherbime:

- Qendra Ditore e të Moshuarve, e cila ka vite që ofron shërbime dhe kujdes për moshën e tretë.
- Qendra Ditore për Fëmijët me Aftësi të Kufizuar, ngritur mbas vitit 2018, në të cilën, jo vetëm PAK marrin shërbime, por punohet si për parandalimin, si për identifikimin e hershëm apo dhe mbështetjen që duhet të kenë në familje dhe komunitet këto persona.
- Qendra e Shërbimeve Emergjente,Mbrojtëse dhe Fuqizuese për Fëmijet dhe Familjen. Kjo Qendër funksionon terësisht me fondin e Bashkisë, por është aplikuar dhe mbeshtetur me Organizatën Ëorld Vision dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Në këtë Qendër kanë marrë shërbime fëmijët që kanë qenë në situatë rreziku dhe nënat që kanë qenë viktima të dhunës në familje,
- Qendra Komunitare Multifunksionale në Rrashbull, pra kemi shtrirje të shërbimeve jo vetëm brenda qytetit, por dhe në zonat rurale.
- Qendra e Këshillimit për Familjen në Sukth, e cila është buxhetuar tërësisht këto vite me buxhetin afatmesëm. Gjithashtu ne shohim dhe mundësitë e partneriteteve me organizata kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe me financime nga pushteti qendror
- Shtëpia e Foshnjës, për të cilën Bashkia e Durrësi është përzgjedhur dhe dy bashki të tjera me qëllim ofrimin e shërbimeve dhe quhen qendra residence për fuqizimin e komuniteteve. Kjo Qendër Rezidence ka shërbyer dhe për njerëzit me nevoja sidomos pas tërmetit, ndodhet tek ambjentet e ish shkollës “Faik Konica”, dhe ka shërbime të gjera dhe nga terreni, gra për mbështetje, mundësi për punësim, të moshuar, apo fëmijëqë kanë nevojë për fizioterapi apo logoped.

Z.Vata tha se jemi në fazën e identifikimit të zonave ku nuk ka shërbime për PAK.

Ai, cilësoi se, Bashkia e Durrësit, përsa i përket ndihmës ekonomike në të vërtetë ka pak familje dhe si e tillë shihet si një Bashki, me një numër të ulët të varfërisë.

Z.Vata, theksoi se kemi shtuar shërbimet duke i ofruar çdo individi apo familje në nevojë që është në situatë rreziku. Prioriteti që kemi pasur në Njësine tuaj Administrative, eshte t'ju ofrojmë një shërbim të menjëhershëm, duke rritur kapacitetet në burimet njerëzore, në trajnimine stafit.
Këto shërbime janë jo fort të dukshme për pjesën më të madhe nga ju, por ato që i marrin këto shërbime e dinë fort mirë.
Eshtë bërë vleresimi i nevojave rast pas rasti. Janë referuar raste për të marrë shërbime dhe nga zona juaj. Perspektiva është që ne ti ngremë këto shërbime në cdo Njësi Administrative.

Në fund të prezantimit, Z.Vata prezantoi në slaidera disa nga shërbimet, përfituesit dhe financimet e kryera në këto qendra të Bashkisë së Durrësit, si më poshtë:

**Qendra Komunitare Multifunksionale Rrashbull**

Qendra ka në fokus mbështetjen, fuqizimin dhe integrimin social të familjeve, veçanërisht për emigrantët e rikthyer nga emigracioni

18

6

**Shërbime:**

- Aktivitete për gjenerimin e të ardhurave në ngritjen e minibizneseve në fusha të ndryshme si psh parukeri-estetikë, rrobaqepsi, blegtori, tregti etj
- Program i formimit të paguar në vëndin e punës
- Këshillim për karrierën
- Mbështetjen pas shkollore
- Klasa prindërimi
- Këshillime individuale dhe në grup me fëmijët, të rinjtë dhe prindërit
- Aktivitete ndërgjegjësuese, kuturore dhe argëtuese me prindërit dhe fëmijët

**Totali përfitues:**
411 persona

**Financimi:**

- Bashkia Durrës
- Terre des Hommes










12/10/2024

## Qendra Komunitare Multifunksionale Nishtulla

Qendra ka për mision për të fuqizuar dhe për të siguruar mirëqenie sociale për komunitetin e Nishtullës përmes ofrimit të asistencës, aktiviteteve dhe shërbime të përkujdesjes transformuese për individët dhe komunitetin.

17

5

**Shërbime:**

- ❑ Këshillimi psikologjik individual dhe në grup;
- ❑ Mbështetja psiko-sociale
- ❑ Manaxhimi i rasteve në nevojë;
- ❑ Shërbimi ditor për fëmijë parashkollorë nga familje të margjinalizuara;
- ❑ Klasa prindërimi/mbështetjeje dhe aftësim për jetën;
- ❑ Shërbim biblioteke dhe kënd lojërash/argëtimi;
- ❑ Mbështetje për punësim;
- ❑ Realizimi i aktiviteteve të ndryshme informuese, kulturore, argëtuese, krijuese, sportive;

**Totali përfitues 2022:**
300 persona

**Financimi:**
Bashkia Durrës






12/10/2024

## Qendra "Fuqizojmë Komunitetin"

- Eshtë pjesë e projektit "Increasing Community Resilience" (ICR) i zbatuar nga UNDP me mbështetjen e Qeverisë së SHBA/USAID në partneritet me Bashkinë Durrës dhe Qendrën për Zhvillim Komunitar "Sot për të Ardhmen" dhe në përputhje me prioritetet e Qeverisë Shqiptare. Qendra ofron shërbime të qëndrueshme, të integruara sociale dhe fuqizuese për komunitetet dhe grupet në nevojë në Bashkinë e Durrësit.

20

8

**Manaxhim Rasti**

- ☐ Vlerësim individual
- ☐ Plan individual ndërhyrje
- ☐ Informacion dhe ndihmë për aksesin në burimet komunitare
- ☐ Ndërhyrje në rast krizash
- ☐ Rritje kapacitetesh dhe mentorim i rrjeteve profesionale
- ☐ Operacionalizimi i NARU (NjVRN)

**Mbështetje për edukim**

- ☐ Kurrikula të përputhura me zhvillimin e fëmijës
- ☐ Programe edukimi të dizenjuara sipas nevojës : analfabetizmi, after-school, aftësi jetësore, terapi arti
- ☐ Shërbime shtesë mbështetëse
- ☐ Mentorim dhe support për mësuesit ndihmës të fëmijëve me AK

**Fuqizim ekonomik**

- ☐ Programe të aftësive të lidershipit
- ☐ Punëtori dhe trajnime mbi komunikimin, zgjidhjen e problemeve dhe zgjidhjen e konflikteve
- ☐ Aktivitetet në grup dhe shërbimi në komunitet
- ☐ Shërbimet e këshillimit dhe mbështetjes sipas nevojës
- ☐ Mbështetje ekonomike për gratë vulnerabël të prekura nga DhF

**Aktivitete psikosociale**

- ☐ Program argëtues dhe zhvillues për kampin veror
- ☐ Një shumëllojshmëri aktivitetesh: sporte, arte dhe vepra artizanale, ushtrime për ndërtimin e ekipit
- ☐ Ndërtimi i marrëdhënieve pozitive me moshatarët dhe të rriturit

**Shërbim Lëvizës**

- ☐ Shërbime këshillimi dhe referimi
- ☐ Terapia fizike, profesionale dhe e të folurit

**Shëndeti mendor**

- ☐ Mbështetje psikologjike për personat me aftësi të kufizuara
- ☐ Terapia fizike, profesionale dhe e të folurit për personat me aftësi të kufizuara
- ☐ Mbështetje psikologjike për prindërit e fëmijëve/të rinjve me aftësi të kufizuara
- ☐ Punëtori për fuqizimin e të mbijetuarve të dhunës
- ☐ Fuqizimi i vetë-efikasitetit për të moshuarit






12/10/2024

**Foto nga Dëgjesa Publike për Programin “Projektet e Shërbimit Social”**
**PBA 2025-2027 në Rrashbull**









Pas prezantimit të këtyre programeve fjalën e morën banorët dhe të pranishmit në sallë të cilët diskutuan rreth këtyre prioriteteve, duke dhënë mendimet, si dhe duke parashtruar kërkesat dhe sugjerimet e tyre.

Pyetje dhe Diskutime

**Njësia Administrative Rrashbull.**

1. Në fshatin Rrashbull.
   - Varrezat, situatë problematike, nuk ka vend mjaftueshëm kërkohet shtim sipërfaqe.
   - Kërkohet një Qendër Shëndetësore, pasi ka shumë banorë.
   - Të rregullohet një pjesë rruge, në kufi me fshatin Arapaj pasi është prishur nga punimet e UKD.

   ZV/Kryetari:Në Njësinë Administrative RRashbull Bashkia Durrës ka bërë shumë investime dhe me projektet që kemi do të bëhen dhe investime të tjera, problemet që u parashtruan do ti mbajmë shënimë dhe normalisht që të gjitha do të merren në konsideratë. Për problemin e varrezave është ngritur një grup pune për të gjitha njesite administrative që ka bashkia dhe po studiohet endi që do të merret toka për shpronësim, do të kemi nje zgjidhje të shpejtë të këtij problemi. Për Qendrën Shëndetësore kemi një marrëveshje me Ministrinë e Shëndetësisë dhe së shpejti do realizohet si projekt.

2. Në Shkallnur një pjesë rruge 60m2 është prishur dhe nuk po rregullohet. Pastrimi i kanalit tek ura përbën rrezik.

3. Në fshatin Arapaj,
   - Transporti për nxënësit e shkollës përbën problem kryesor,
   - Mungon siguria në shkollë, pa roje,kamera sigurie dhe kabinete.
   - Mungon një çerdhe afër kopshtit në Arapaj.
   - Në të gjith projektet që hartohen nuk merren parasysh gjithëpërfshirja për personat me aftësi të kufizuar.
   - Mungojnë parkimet e rezervuara për personat me aftësi të kufizuar, mungojne rampat në rrugë,
   - Nuk funksionon sinjali akustik në mjetet e transportit publik:
   - Në stacionet e autobuzave duhet të vendoset njoftimi i orarit te lëvizjes së autobuzave.

Drejtor i Drejtorisë së Arsimit: Për transportin e nxënësve i kemi bërë një kërkësë Ministrisë dhe jemi në pritje të përgjigjes, për sa i përket çerdhes në Arapaj kjo nuk është e mundur pasi ajnë vetëm 5 fëmijë dhe për 5 fëmijë nuk mund të ndërtojmë një çerdhe dhe të vendosim 4 kujdestare sepse është e pamundur. Bashkia ka vendosur rreth 68 roje ne shkollat ndërsa për kabinetet duhet tja delegoni kërkesën institucionit përkatës.

4. Rruga tek Gjykata e Apelit është e ngushtë dhe një kalimshe shkakton vështirësi në lëvizshmëri.

5. Përfaqësues në fshatin Shënvlash, problem kryesor shkolla e rikonstruktuar pasi ndalohet transporti falas i nxënësve ndërkohë ka familje me disa fëmijë që nuk përballojnë dot pagesën.

Drejtor i Drejtorisë së Arsimit: Do të rishikojmë transportin për fëmijët.

6. Rruga nga Rrethrrotullimi i Shënvlashit deri tek Sektori Rinia duhet një projekt për rregullim.

Drejtori i drejtorisë së projekteve: Shtrimi i rrugës do të bëhet nga ARSH dhe investimi është i tyre, kemi kërkuar rikonstruksion rruge dhe e kemi prioritet, shpresojmë që do të realizohet së shpejti.

7. Tek Fabrika e betonit është një rrugë prej 1km që ka nevojë të shtrohet.

8. Lagja Mirdita ka nevojë për kanalizime dhe pastrimin e ujërave të zeza sepse ka përmbytje.

9. Ka problem me legalizimet e pronave.

ZV/Kryetari: Në bazë të një marrëveshje me ASHK do të fillojmë proçedurat fillestare.

10. Rreth 25 mijë nxënës në Fshatin Fllakë që i përkasin familjeve në nevojë nuk kanë transport.

11. Femijët e fshatit Vllazerim që i përkasin Bashkisë Shijak ndjekin shkollën në Xhafzotaj për shkak të afërsisë që kanë, problem i tyre mbetet transporti pasi nuk mund të kalojnë në shkollat e Bashkisë Shijak, janë 23 mijë nxënës pasi në Fshatin Vllazërim nuk ka shkollë .

12. Siguria në Shkollën Xhafzotaj pas orarit mësimor është e ulët dhe shfaqen problematika të ndryshme, kërkohet të vendosen kamerat e sigurisë.

13. Mungon terreni sportive në ambientet e shkollës, ka nevojë për rregullim dhe ndërhyrje dhe paisjen me mjete për të zhvilluar orarin mësimor.

14. Qëndre Multifunksionale duhet të ndihmojë komunitetin për parandalimin e rrjeteve sociale tek fëmijët.

15. Në Fshatin Xhafzotaj,
    - Kanalet kulluese tek pallatet 5 katëshe janë pa pastruar dhe janë bllokuar.
    - Në nga pallatet 5 katëshe pas tërmetit u rikonstruktua por pallati akoma ka shfaqur problem me tavanin dhe fasadat pasi janë çarë dhe krisur.

16. Rruga e re e Shenvlashit po dëmtohet nga UKD.

ZV/Kryetari:Do të takojë përfaqësues të UKD në lidhje me investimet që po realizojnë.

17. Në fshatin Arapaj, Shkolla "Myslym Hida", ka probleme me palestrën e shkollës dhe penxhere të thyera dhe nuk ka bazë material.

18. Rrugët nëpër lagje duhet të rishikohen pasi banorët kanë vështirësi në kohë të keqe.

## Rekomandimet për dëgjesat publike 2025-2027

**Njësia Administrative Rrashbull.**

1. Në fshatin Rrashbull.
   - Varrezat, situatë problematike, nuk ka vend mjaftueshëm kërkohet shtim sipërfaqe .
   - Kërkohet një Qendër Shëndetësore, pasi ka shumë banorë.
   - Të rregullohet një pjesë rruge, në kufi me fshatin Arapaj pasi është prishur nga punimet e UKD.

2. Në Shkallnur një pjesë rruge 60m2 është prishur dhe nuk po rregullohet. Pastrimi i kanalit tek ura përbën rrezik.
3. Në fshatin Arapaj,
   - Transporti për nxënësit e shkollës përbën problem kryesor,
   - Mungon siguria në shkollë, pa roje dhe kamera sigurie.
   - Mungon një çerdhe afër kopshtit në Arapaj.
   - Në të gjith projektet që hartohen nuk merren parasysh gjithëpërfshirja për personat me aftësi të kufizuar.
   - Mungojnë parkimet e rezervuara për personat me aftësi të kufizuar, mungojne rampat në rrugë,
   - Nuk funksionon sinjali akustik në mjetet e transportit publik:
   - Në stacionet e autobuzave duhet të vendoset njoftimi i orarit te lëvizjes së autobuzave.
4. Rruga tek Gjykata e Apelit është e ngushtë dhe një kalimshe shkakton vështirësi në lëvizshmëri.
5. Në fshatin Shënvlash, problem kryesor shkolla e rikonstruktuar pasi ndalohet transporti falas i nxënësve ndërkohë ka familje me disa fëmijë që nuk përballojnë dot pagesën.
6. Rruga nga Rrethrrotullimi i Shënvlashit deri tek Sektori Rinia duhet një projekt për rregullim.
7. Tek Fabrika e betonit është një rrugë prej 1km që ka nevojë të shtrohet.
8. Lagja Mirdita ka nevojë për kanalizime dhe pastrimin e ujërave të zeza sepse ka përmbytje.
9. Ka problem me legalizimet e pronave.
10. Rreth 25 mijë nxënës në Fshatin Fllakë që i përkasin familjeve në nevojë nuk kanë transport.
11. Femijët e fshatit Vllazerim që i përkasin Bashkisë Shijak ndjekin shkollën në Xhafzotaj për shkak të afërsisë që kanë, problem i tyre mbetet transporti pasi nuk mund të kalojnë në shkollat e Bashkisë Shijak, janë 23 mijë nxënës pasi në Fshatin Vllazërim nuk ka shkollë .
12. Siguria në Shkollën Xhafzotaj pas orarit mësimor është e ulët dhe shfaqen problematika të ndryshme, kërkohet të vendosen kamerat e sigurisë.
13. Mungon terreni sportive në ambientet e shkollës, ka nevojë për rregllim dhe ndërhyrje dhe paisjen me mjete për të zhvilluar orarin mësimor.

14. Qëndre Multifunksionale duhet të ndihmojë komunitetin për parandalimin e rrjeteve sociale tek fëmijët.
15. Në Fshatin Xhafzotaj,
    - Kanalet kulluese tek pallatet 5 katëshe janë pa pastruar dhe janë bllokuar.
    - Në nga pallatet 5 katëshe pas tërmetit u rikonstruktua por pallati akoma ka shfaqur problem me tavanin dhe fasadat pasi janë çarë dhe krisur.
16. Rruga e re e Shenvlashit po dëmtohet nga UKD.

17. Në fshatin Arapaj, Shkolla “Myslym Hida”, ka probleme me palestrën e shkollës dhe penxhere të thyera dhe nuk ka bazë material.
18. Rrugët nëpër lagje duhet të rishikohen pasi banorët kanë vështirësi në kohë të keqe.

**Dëgjesat Publike 2025-2027**

**Dëgjesa IV**

Data 14.10.2024.

Vendi i takimit: Ambjentet e shkolles “B.Curri”, Plazh, Durres.

Ora: 10°°-14°°

Në këtë takim kishte një pjesmarrje të gjerë, ku të pranishëm ishin përfaqësues të komunitetit të Njësisë Administrative, përfaqësues të grupeve të interesit, përfaqësues të Këshillit Bashkiak, Institucioneve Arsimore, OSHE, Emergjenca Civile, Ujësjellës-Kanalizime, OJF që operojne në këtë Nj.A Nr.5 dhe Nr.6.

Pjesmarrës në takim, sipas listë prezencës, 73 persona.

Takimin e hapi N/Kryetari i Bashkisë, Z. Elio Jani. Në fjalën e tij ai tha:

Përshëndetje të gjithëve. Sot do të zhvillojmë dëgjesën publike për buxhetin e vitit 2024 dhe PBA 2025-2027 për Njësinë Administrative Nr.5 dhe Nr.6, ku do të bëjmë një panoramë të investimeve që janë bërë në këto njësi, gjithashtu do tju prezantojmë dhe projektet e reja që do të zbatohen përgjatë harkut kohor 2025-2027. Në fund të prezantimit të të tre programeve nga drejtorët, do të bashkëbisedojmë për të dëgjuar kërkesat dhe sugjerimet tuaja.

Më tej dëgjesa vazhdoi me prezantimin e tre programeve buxhetore për PBA 2025-2027, të cilët u prezantuan nga Drejtorët e Drejtorive përkatëse të Bashkisë Durrës.

U prezantuan objektivat për investimet në infrastrukturë rrugore në Projekt Buxhetin e vitit 2025-2027, ndërtimin e 27 rrugëve dhe rrugicave së bashku në Njësinë Administrative Nr.5 dhe Nr.6, ndërsa projektet në infrastrukturën publike për vitin 2025-2027 përfshijne rikonstruksionin dhe ndërtimin e qendrave shëndetësore, rikonstruksion dhe ndërtimin e kopshteve dhe çerdheve, krijimin e hapësirave publike si dhe kënde lojërash për fëmijë, ndërtimin e terreneve sportive si dhe pastrimin dhe rehabilitimin e sistemit të kullimit të cilat do të jenë prioritet për vitet e ardhshme.

Një nga projektet më madhorë, që do të fillojë së shpejti, është Palestra e mbyllur e Shkollës Abedin Dino, projekti më madhor i kësaj zone, si dhe do të vazhdojë deri në përfundim Faza e dytë e rehabilitimit të Shetitores së Plazhit, nga Kanal Grande, deri tek Ura e Dajlanit, dhe shtim i brezit të rërës rreth 30m për shfrytëzimin e plazhit.

Pas prezantimit të këtyre programeve, fjalën e morën banorët dhe të pranishmit në sallë, të cilët diskutuan rreth këtyre prioriteteve, duke dhënë mendimet dhe duke parashtruar kërkesat dhe sugjerimet e tyre.

**Dëgjesa publike për Programin “Arsimi parashkollor dhe parauniversitar ” dhe programi “Shërbimet Publike, Investimet në Arsim” PBA 2025-2027 në Nj. Administrative Nr. 5**

Më pas e mori fjalën Drejtori në Drejtorinë e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe komunitete Fetare, z. Adrian Gurra, i cili bëri prezantimin për programin “Arsimi parashkollor dhe parauniversitar dhe investimet në arsim” **për PBA 2025-2027.**

**Qëllimi i takimit:** Përthithja nëpërmjet Dëgjesave Publike, të mendimeve dhe sugjerimeve të aktorëve të ndryshëm të fushës për të realizuar një buxhet sa më pranë qytetarëve dhe nevojave të tyre. Përcaktimi i prioriteteve të investimeve në Arsim në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së infrastrukturës arsimore, duke ofruar shërbime eficente dhe cilësore për vitin në vazhdim 2024 dhe për projekt buxhetin afatmesëm 2025-2027.

**Prezantimi i Drejtorit të Arsimit, z. Adrian Gurra**

**z. Gurra** e filloi prezantimin mbi qëllimin e dëgjesës dhe rëndësinë e saj dhe sesi mendojmë ne që nga diskutimet e përbashkëta të vendosim sa më mirë dhe drejtë për prioritetet në fushën e arsimit, kulturës dhe sportit.
Z. Gurra, bëri një analizë të detajuar mbi arsimin dhe objektivat e tij deri në vitin 2027,investimet e bëra nga Bashkia Durrës në vitin 2024, dhe cilat janë ato që do të kryhen për vitet 2025-2027.
z. Gurra, referoi për të gjitha investimet e kryera në Institucionet Arsimore gjatë vitit 2024 duke u ndalur kryesisht për cdo investim të kryer në Njësinë Administrative Nr.5 dhe kryesisht në zonën e Plazhit dhe të Shkozetit. Fokusi kryesor i investimeve në arsim, ishte ai i procesit të rindërtimit si dhe në investimet që parashikohen të bëhen në institucionet arsimore gjatë viteve 2025-2027.



**2-Programi i dytë: Investime me fondet e veta të NJQV (Bashkisë Durrës)**

VITI 2025-26

- Ndërtim shkolla 9 vjeçare "Met Hasa "/proces lidhje kontrate
- Ndërtim shkolle e re nga bashkimi i 2 shkollave 9 vjeçare: "Vasil Ziu" dhe "Nënë Tereza" /2026
- Ndertim I terreneve te mbyllura sportive ne shkollat 9 vjecare “Jusuf Puka” dhe “Abedin Dino”
- Rikonstruksion total shkolla 9 vjecare “Bajram Curri”

VITI 2027

- Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare “Hamza Muca“
- Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare “Jubë“
- Rikonstruksion godina e shk 9 vj “Bishtkamëz”
- Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare “Pal Zefi”, Rrushkull

## Objekte te perfunduara brenda vitit 2024, nga program me fonde te Bashkise Durres

VITI 2024

- Rikonstruksion shkolla MB "Besnik Hidri", Shënvlash/perfunduar Janar 2024
- Rikonstruksion Qendra Kulturore e Fëmijëve/perfunduar Qershor 2024
- Rikonstruksion gjimnazi "Dom Nikoll Kaçorri“/perfunduar Shtator 2024
- Ndërtim terreni sportiv i mbuluar multifunksional ne bashkefinancim me World Vizion ne shkollen e Re, Kenete (drejt perfundimit)
- Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare "Demokracia“/perfundon ne nentor 2024
- Ndertim kabine elektrike dhe pajisje per shkollat “Naim Frasheri” dhe “Benardina Qerraxhi”

# Objekte arsimore plazh/shkozet

- Shkolla 9 vjeçare “Abedin Dino” (Ndërtim I ri me fondet e BD/2016,ndertim I terreneve te mbuluara sportive me taksen e arsimit nentor 2024)
- Shkolla 9 vjeçare “Bajram Curri” (Rikonstruksion total viti 2026)
- Shkolla 9 vjeçare “Isuf Ferra” (Rikonstruksion me fondet e BD/2018) Palestra e shkolles 9 vjecare “Isuf Ferra” perfunduar shtator 2024 me prog.CIS zbatuar UNDP
- Kopshti "Isuf Ferra“, Durrës/perfunduar 2024 dhe fillon tani funksionimin si kopesht me ushqim.
- Shkolla e mesme ”Olsi Lasko” (Ndërtim I ri EU4Schools zbatuar UNDP /përfunduar në korrik 2023)
- Shkolla 9 vjeçare “Hasan Koçi” (Ndërtim I ri FSHZH/2020)
- Konvikti I shkollës së mesme profesionale “Beqir Cela” (Ndërtim I ri/perfundon janar 2025)

# Objektivat 2025

- Mirëmbajtja e godinave arsimore
- Mirëmbajtja e sistemeve ngrohje ftohje në institucione arsimore
- Shpërblimin e nxënësve të klasave të 9-ta me rezultate të shkëlqyera.
- ❖ Që nga viti 2022 Bashkia Durrës ka shpërblyer 151 nxënës /për vitin 2021-2023
- Shpërblimi i nxënësve të shkollave të mesme për vitin 2022-2023/me rezultate të shkëlqyera dhe fituesit e tre vendeve të para të olimpiadave kombëtare
- ❖ Që nga viti 2017-2023 Bashkia Durrës ka shpërblyer 218 nxënës të shkollave të mesme).

**Foto nga Dëgjesa Publike për Programin “Arsimi parashkollor dhe parauniversitar ” dhe programi “Shërbimet Publike, Investimet në Arsim” PBA 2025-2027 në Nj.A Nr. 5**





**Dëgjesa Publike e Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publik për PBA 2024-2026 në Nj. Administrative Nr. 5 (Plazh-Shkozet)**

Më pas e mori fjalën Drejtori i Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike , z. Lorenc Facja, i cili bëri prezantimin e Programit të Projekteve dhe Investimeve të Infrastrukturës Publike për PBA 2025-2027.

**Prezantimi i drejtorit të Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike** .

Drejtori i Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike , z. Lorenc Facja, u bëri të ditur pjesëmarrësve se këto takime po bëhen në kuadër të realizimit të dëgjesave publike për të bërë të mundur më pas përgatitjen e Buxhetit Afatmesëm 2025-2027 lidhur me investimet në infrastrukturën rrugore dhe shërbimet publike.

**Qëllimi i programit**: Përthithja nëpërmjet dëgjesave të mendimit të aktorëve të ndryshëm të fushës për të realizuar një buxhet sa më pranë qytetarëve dhe nevojave të tyre.

Përcaktimi i prioriteteve të investimeve në infrastrukturë në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë duke ofruar shërbime eficente dhe cilësore.

z.Facja, informoi të pranishmit lidhur me programin e **"Infrastrukturës rrugore dhe Transportit Publik"**, duke u përqëndruar kryesisht në informimin e pjesëmarrësve mbi investimet e kryera gjatë vitit 2024, në Njësinë Administrative Nr. 5, dhe parashikimi për investimet në infrastrukturën rrugore për këtë Njësi Administrative gjatë tre viteve në vazhdim 2025-2027.

z.Facja, theksoi se: Kemi realizuar investime si në zonën e Plazhit, ashtu dhe në zonën e  Shkozetit
Gjatë prezantimit, z. L.Facja, bëri me dije se investimet e kryera nga Bashkia Durrës për vitin 2024 për Nj. Administrative Nr. 5 (Plazh- Shkozet).
Ai prezantoi investimet e kryera në infrastrukturën rrugore gjatë vitit 2024 në Lagjen Nr.13 në Plazh dhe Shkozet si dhe investimet që do të bëhen gjatë viteve 2025-2027, të cilat janë si më poshtë:

# 1. INFRASTRUKTURE RRUGORE TE REALIZUAR NE VITIN 2024

## Rajonin nr.5

Rruge te realizuara

- Rruga At Zef Pellumbi 90ml
- Rruga Lule Bore 159ml
- Rruga Antalia 682ml
- Rruga Amsterdam 425ml
- Rruga Kepi I Rodonit 340ml
- Rruga Puhija e Detit 222ml
- Rruga Lasgush Poradeci 500 ml
- Rrugica Rifat Peshkatari 112ml

Total 2530 ml

Rruge te per tu realizuara Brenda 2024

- Rruga Vrrini 400ml
- Rruga Erzeni 350ml
- Rruga Polikseni Lulo 300ml
- Rruga Ullishteve 145ml
- Dora Distria 160ml
- Laz Caushl 150ml

Total 1505 ml






# 3. OBJEKTIVAT PER VITIN 2025-2027

## PROJEKTE NE INFRASTRUKTURE RRUGORE NE VITIN 2025

| ZONA | RAJONI | EMRI I RRUGES | GJATESIA ML | GJERESIA ML | SIPERFAQE M2 |
|---|---|---|---|---|---|
| PLAZH | RAJONI 5 | KALABRIA+ RUUGICA | 235 | 3.5 | 822.5 |
| PLAZH | RAJONI 5 | XHZVDET AFIZI | 485 | 3.0 | 1,455 |
| PLAZH | RAJONI 5 | LIDHJA E PRIZERENIT | 135 | 3.5 | 472.5 |
| PLAZH | RAJONI 5 | RRUGA E PLEPAVE (ENKELEJDEVE) | 50 | 3.5 | 175 |
| PLAZH | RAJONI 5 | RRUGICA KALI TROJES (PAVARSIA) | 90 | 4 | 360 |
| PLAZH | RAJONI 5 | RRUGICA SHEN MHILLI ( PAVARSIA) | 85 | 4 | 340 |
| PLAZH | RAJONI 5 | RRUGICA 00690611 ( PAVARSIA) | 95 | 3 | 285 |
| PLAZH | RAJONI 5 | RRUGICA MBRAPA ANTALIAS | 90 | 4.5 | 405 |
| PLAZH | RAJONI 5 | RRUGICA PELIKAN (PALLATET GORA) | 250 | 3 | 750 |
| PLAZH | RAJONI 5 | RRUGICA LULE BORE (ISH HOTEL KRUJA) | 120 | 3.5 | 420 |
| PLAZH | RAJONI 5 | JUSUF MYZYRI | 200 | 5 | 1000 |
| PLAZH | RAJONI 5 | VENECIA | 90 | 5 | 450 |
| PLAZH | RAJONI 5 | RRUGICA PERBALL FLORIDES | 300 | 4 | 1200 |
| PLAZH | RAJONI 5 | RRUGICA PALLATI DRINI TUSHE | 100 | 4 | 400 |
| PLAZH | RAJONI 5 | RRUGICA PALLATI ARABIT ILIRIA | 150 | 3 | 450 |
| PLAZH | RAJONI 5 | DORA DISTRIA | 150 | 3.0 | 450 |
| SHKOZET | RAJONI 5 | RAQ MANUSHI | 165 | 3.5 | 577.5 |
| SHKOZET | RAJONI 5 | KUVENDI I LEZHES | 275 | 3.5 | 962.5 |
| SHKOZET | RAJONI 5 | BESLIDHJA | 127 | 3.5 | 444.5 |
| SHKOZET | RAJONI 5 | VACE ZELA | 350 | 3.5 | 1225 |
| SHKOZET | RAJONI 5 | ZHAN GABEN | 190 | 3.5 | 665 |
| SHKOZET | RAJONI 5 | PRANVERA | 480 | 3 | 1440 |
| SHKOZET | RAJONI 5 | MIT SOKOLI DHE AZEM GALICA | 200 | 3 | 600 |
| SHKOZET | RAJONI 5 | RRUGICA MARTIN CAMAJ ( RRUGE E MBYLLUR) | 140.8 | 3 | 422.4 |
| SHKOZET | RAJONI 5 | RRUGA HEROJNTE E KOMBIT | 227.8 | 3 | 683.4 |
| SHKOZET | RAJONI 5 | IBRAHIM TUKICI | 177.6 | 3 | 532.8 |
| SHKOZET | RAJONI 5 | PJETER GACI | 121.4 | 3 | 364.2 |

# 4. PROJEKTE NE INFRASTRUKTURE PUBLIKE 2024

-Krijimin e hapsirave publike dhe kende lodrash per femije sheshi prane shkolles “Bajram Curri”

-Krijimin e hapsirave publike dhe kende lodrash per femije sheshi ne Nishtulla.

-Ndertimin e terreneve sportive ne shkollen “Abedin Dino”

- Rehabilitim i shetitores se plazhit faza 2 .
- Rikonstruksion i rruges “Adria”

-Pastrim dhe rehabilitim te sistemit te kullimit













## 5. PROJEKTE NE INFRASTRUKTURE PUBLIKE 2025-2027

-Rikonstruksion dhe ndertim i qendrave shendetesore

-Rikonstruksion dhe ndertim te kopeshteve/çerdheve

-Krijimin e hapsirave publike dhe kende lodrash per femije

-Ndertimin e terreneve sportive

-Ndricim i rrugeve ne plazh.

-Pastrim dhe rehabilitim te sistemit te kullimit

**Foto nga Dëgjesa Publike për programin e “Infrastrukturës rrugore dhe Transportit Publik”, për PBA 2025-2027 në Nj.Administrative Nr. 5**






**Dëgjesa Publike për Programin "Projektet e Shërbimit Social" PBA 2025-2027**
**Drejtoria e Shërbimit Social në Nj. Administrative Nr. 5**

Më pas e mori fjalën Drejtorja e Drejtorisë së Shërbimit Social znj. Meme Xhaferraj, e cila bëri prezantimin e **"Projekteve të Shërbimit Social" për PBA 2025-2027.**

**Qëllimi i takimit:** Informimi i pjesëmarrësve me politikat e përmirësimit të kushteve për zhvillimin e sistemit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror në Bashkinë Durrës dhe përmirësimi i shërbimeve sociale në territorin e Bashkis Durrës për vitin në vazhdim 2024, dhe marrja e opinioneve të tyre për të përmirësuar shërbimet sociale dhe shërbimet e përkujdesit shoqëror për projekt buxhetin afatmesëm 2025-2027.

**Prezantimi i drejtores së Drejtorisë së Shërbimit Social**

Drejtorja e Drejtorisë së Shërbimit Social znj. Meme Xhaferraj, u bëri të ditur pjesëmarrësve se këto takime po bëhen në kuadër të realizimit të dëgjesave publike për të bërë të mundur më pas përgatitjen e Buxhetit Afatmesëm 2025-2027 lidhur me projektet e Shërbimit Social.

znj. Meme Xhaferaj, theksoi se Bashkia Durrës ka hartuar Planin e shërbimeve sociale, i cili është bazuar në qasjen e ofrimit të një pakete shërbimesh për të gjitha kategoritë e grupeve në nevojë si dhe në filozofinë e ndërtimit të partneritetit midis aktorëve të ndryshëm, si institucionet e qeverisjes vendore dhe rajonale, organizatat ndërkombëtare, kombëtare dheato lokale, si dhe biznesin vendor si një mbështetës potencial në fuqizimin e shërbimeve sociale.

Gjatë prezantimit, znj.Meme Xhaferraj bëri një pasqyrë të situates aktuale, detyrat dhe përgjegjësitë e Pushtetit Vendor si dhe u ndal në shërbimet sociale që po kryhen në Bashkinë e Durrësit gjatë vitit 2024 dhe për vitet 2025-2027.




FËMIJËT
Ofrimi I shërbimeve të emergjencës për fëmijët në situate rreziku të lartë;
Ngritja e shërbimeve të mbështetjes psiko -emocionale për fëmijët e abuzuar:
Ngritja e shërbimit të Kujdestarisë;
Mirë menaxhimi i rasteve te femijeve ne nevoje


GRATË DHE VAJZAT
Mbështetjae grave dhe vajzave nevojënë programe te strehimit.
Mbeshtetja e grave dhe vajzave programet e informimit dhe ndërmjetësimi për punësim.
Ofrimi i shërbimeve ligjore falas për gratë kryefamiljare dhe të mbijetuara nga DHF dhe trafikimi.
TË MBIJETUARIT E DHF DHE DHBGJ
Ofrimi i shërbimeve të mbështetjes psiko-sociale për të mbijetuarit e DHF;
Ofrimi i asistencës ligjore falas.
Ofrimi I shërbimeve të emergjencës për rastet e DHF dhe DHBGJ;
Programe për fuqizimin ekonomik të mbijetuarve të DHF dhe trafikimit.




Znj. Xhaferraj, theksoi se kemi shtuar shërbimet duke i ofruar çdo individi apo familje në nevojë që është në situatë rreziku.
Perspektiva është që ne ti ngremë këto shërbime në cdo Njësi Administrative.

- Drejtoria e Shërbimit Social në Bashkinë Durrës ka filluar zbatimin e projektit: “Qendra e Shërbimeve Mbrojtëse, Fuqizuese, Emergjente për Fëmijët dhe Familjen” me mbështetjen e Fondit Social të Ëorld Vision dhe Bashkisë Durrës.
- Po punohet për Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2027, i cili është konsultuar me të gjithë aktorët e shoqërisë civile dhe është publikuar në faqen e Bashkisë deri në miratimin në Këshill Bashkiak.

Shërbimet mbrojtëse, fuqizuese dhe emergjente që jepen për fëmijët dhe familjet nga Qendra për Shërbime Mbojtëse, Fuqizuese dhe Emergjente jepen në tabelën e mëposhtëme:

## Qendra për Shërbime Mbrojtëse, Fuqizuese dhe Emergjente për Fëmijën dhe Familjen

15

Qendra ka për mision "Mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror si dhe të ofrojë shërbime që synojnë të ndikojnë pozitivisht në jetën e fëmijëve, të rinjve dhe familjeve të tyre në situatë vulnerabël", me fokus kryesor mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, abuzimi, neglizhimi dhe shfrytëzimi.

3

**Shërbimet:**

**I. *Shërbimi emergjent i mbrojtjes 72+ orë*** për fëmijët në nevojë për mbrojtje të menjëhershme pa kujdes prindëror ose të dhunuar, fëmijë të rrugës, të shfrytëzuar, të abuzuar dhe gra e fëmijë viktima të dhunës në familje të cilëve ju ofrohet:

- ❑ Strehimi
- ❑ Mbulimi i nevojave shëndetësore, mirëqenia e fëmijëve
- ❑ Mbulimi i nevojave ushqimore
- ❑ Manaxhimi i problemeve të shëndetit mendor të fëmijëve
- ❑ Sigurimi i materialeve të buta
- ❑ Siguria për jetën

**II. *Shërbime mbështetëse me qëllim zhvillimin komunitar***

- ❑ Programe për fuqizimin dhe zhvillimin pozitiv të fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve: mbështetje psiko-sociale, trainime, ëorkshope
- ❑ Aktivitete komunitare ndërgjegjësuse për rritjen e kapacitetit të tyre në fushat e mirëqënies sociale.

**Totali përfitues:**
316 fëmijë dhe 98 të rritur

**Përfitues 2022:**
164 fëmijë dhe 57 të rritur

**Financimi:**
- ❑ Fondi social (MSHMS) – 30%
- ❑ Bashkia – 30%
- ❑ ëorld Vision – 40%






12/10/2024

## Qendra "Fuqizojmë Komunitetin"

- Eshtë pjesë e projektit "Increasing Community Resilience" (ICR) i zbatuar nga UNDP me mbështetjen e Qeverisë së SHBA/USAID në partneritet me Bashkinë Durrës dhe Qendrën për Zhvillim Komunitar "Sot për të Ardhmen" dhe në përputhje me prioritetet e Qeverisë Shqiptare. Qendra ofron shërbime të qëndrueshme, të integruara sociale dhe fuqizuese për komunitetet dhe grupet në nevojë në Bashkinë e Durrësit.

20

8

**Manaxhim Rasti**
- Vlerësim individual
- Plan individual ndërhyrje
- Informacion dhe ndihmë për aksesin në burimet komunitare
- Ndërhyrje në rast krizash
- Rritje kapacitetesh dhe mentorim i rrjeteve profesionale
- Operacionalizimi i NARU (NjVRN)

**Mbështetje për edukim**
- Kurrikula të përputhura me zhvillimin e fëmijës
- Programe edukimi të dizenjuara sipas nevojës : analfabetizmi, after-school, aftësi jetësore, terapi arti
- Shërbime shtesë mbështetëse
- Mentorim dhe support për mësuesit ndihmës të fëmijëve me AK

**Fuqizim ekonomik**
- Programe të aftësive të lidershipit
- Punëtori dhe trajnime mbi komunikimin, zgjidhjen e problemeve dhe zgjidhjen e konflikteve
- Aktivitetet në grup dhe shërbimi në komunitet
- Shërbimet e këshillimit dhe mbështetjes sipas nevojës
- Mbështetje ekonomike për gratë vulnerabël të prekura nga DhF

**Aktivitete psikosociale**
- Program argëtues dhe zhvillues për kampin veror
- Një shumëllojshmëri aktivitetesh: sporte, arte dhe vepra artizanale, ushtrime për ndërtimin e ekipit
- Ndërtimi i marrëdhënieve pozitive me moshatarët dhe të rriturit

**Shërbim Lëvizës**
- Shërbime këshillimi dhe referimi
- Terapia fizike, profesionale dhe e të folurit

**Shëndeti mendor**
- Mbështetje psikologjike për personat me aftësi të kufizuara
- Terapia fizike, profesionale dhe e të folurit për personat me aftësi të kufizuara
- Mbështetje psikologjike për prindërit e fëmijëve/të rinjve me aftësi të kufizuara
- Punëtori për fuqizimin e të mbijetuarve të dhunës
- Fuqizimi i vetë-efikasitetit për të moshuarit






12/10/2024

**Foto nga Dëgjesa Publike për Programin “Projektet e Shërbimit Social”**
**PBA 2025-2027 me Nj. Administrative Nr. 5**





Pyetje dhe Diskutime

**Plazh, Shkozet (NJ.A. 5)**

1. Për shkollën “B.Curri”
   - Të rregullohen tualetet e shkollës.
   - Shkolla nuk ka ngrohje.
   - Të rregullohet tarraca e shkollës.
   - Palestra nuk është efektive.

Zv/Kryetari:

- Është përcaktuar buxheti për rikonstruksionin e shkollës.

2. Banore Plazh

- Kabinat e Plazhit janë prishur nga tërmeti, banorët kërkojnë zgjidhje të problemit pasi kanë ngelur të pastrehë.

Zv/Kryetari:

- Është proçedurë me njësinë bashkiake dhe duhet të bëhet deklaratë për të përfituar banesë sociale. Kërkesat për miratim kalojnë me proçedurë në Këshill Bashkiak.

3. Banore, Plazh

- Sa kohë duhet të presim për banesa sociale. Sa zgjasin proçedurat?

4. Banor, Plazh

- Rruga “Ampula” është e pashtruar dhe ujërat e zeza janë pa sistemuar.

Drejtori i Drejtorise së projekteve:

- Rruga është prioritet për buxhetin 2025-2027. Do të bëhen kanalizimet për vazhdimin e rrugës, sepse është nën kuotë.

5. Studente, Plazh

- Kërkesë për shtrim rruge dhe sistemimin e ujërave të zeza në rrugën “Eqerem Çabej” përfitues rreth 40 familje.

ZV/Kryetari:

- Do të shikojmë mundësinë për investime, ose Ndërmarrja Rrugëve do të bëjë sistemime.

6. Banore e l.13 Plazh

- Kërkesë për rikonstruksionin e“Vila 10”, ose privatizimin.

Kryetari i Rajonit:

- Vila 10, është me dëmtime nga tërmeti i nentorit të vitit 2019. Sipas Institutit të Ndërtimit, po bëhet ekspertiza dhe do të fillojë proçedura për rindërtimin dhe jo për shembjen e objektit.

7. Banor i Lagjes 13, Plazh

- Të rishikohet investimi që është bërë në rrugën dytësore, tek pallati “Tartari” ,pasi ndriçimi është lënë përgjysëm, gjithashtu dhe rruga.

Drejtori i Drejtorise së projekteve:

- Kjo rrugë, është investuar nga FSHZH, dhe për pjesën tjetër të rrugës, do të merret Bashkia, sepse fondi ka qënë i kufizuar.

8. Banore L.13

- Vendosja e ndriçimit në rrugën “Qafë Botë”.

9. Banore, L.13

- Të jepet informacion se çfarë do të bëhet me banorët e “Vila 28”, pasi janë në kushte të vështira financiare.

Kryetari i Rajonit:

- Vila 28, do të veprohet në pritje të përfundimit të ekspertizës.

10. Asfaltimi i rrugëve “Azem Galica”.

Kryetari i Rajonit:

- Do të rishikojmë situatën dhe do të veprojmë.

11. Banor, L.13

- Kërkesë për legalizim banese.

Kryetari i Rajonit:

- Legalizimet për shtëpitë që nuk kanë pasur proçedurë. Do të bëhen matjet nga grupi i punës së Bashkisë.

12. Banor L.13

- Të investohet në rrugën “1 Qershori”
    - Kanali i bllokuar vjen erë të papërshtatshme, të bëhët mbyllja e tij.
    - Rruga e pashtruar.
    - Mungon ndriçimi.

Drejtori i Drejtorise së projekteve:

- Do ta vlerësojmë, që ta bëjmë prioritet për buxhetin AM 2025-2027.

13. Banore L.13 Plazh

- Vendosja e koshave tek Shëtitorja e re në Plazh.

Kryetari i Rajonit:

- Po vazhdon projekti.

14. Banore, L.14 Shkozet

- Të vendoset sinjalistika në Rrethrrotullimin e Shkozetit.

15. Banore, pjesë e Shoqërise Civile.

- Të jepen leje për shitës ambulant, për gratë në nevojë, që duan të shesin punimet artizanale dhe pensionistë që shesin misra.

Kryetari i Rajonit:

- Leje për ambulant jepen sipas proçedurës.

**Rekomandimet për dëgjesat publike 2025-2027**

**Plazh, Shkozet ( NJ.A. 5)**

1. Për shkollën "B.Curri"
   - Të rregullohen tualetet e shkollës.
   - Shkolla nuk ka ngrohje.
   - Të rregullohet tarraca e shkollës.
   - Palestra nuk është efektive.
2. Kabinat e Plazhit janë prishur nga tërmeti, banorët kërkojnë zgjidhje të problemit pasi kanë ngelur të pastrehë.
3. Sa kohë duhet të presin për banesa sociale.
4. Rruga "Ampula" është e pashtruar dhe ujërat e zeza janë pa sistemuar.
5. Kërkesë për shtrim rruge dhe sistemimin e ujërave të zeza në rrugën "Eqerem Çabej" përfitues rreth 40 familje.
6. Kërkesë për rikonstruksionin e"Vila 10"
7. Të rishikohet investimi që është bërë në rrugën dytësore te pallati "Tartari" pasi ndriçimi është lënë përgjysëm gjithashtu dhe rruga.
8. Vendosja e ndriçimit në rrugën "Qafë Botë".
9. Të jepet informacion se çfarë do të bëhet me banorët e "Vila 28" pasi janë në kushte të vështira financiare.
10. Asfaltimi i rrugëve "Azem Galica".
11. Kërkesë për legalizim banese.
12. Të investohet në rrugën "1 Qershori"
    - Kanali i bllokuar vjen enë të papërshtatshme, të bëhët mbyllja e tij.
    - Rruga e pashtruar.
    - Mungon ndriçimi.
13. Vendosja e koshave te Shëtitorja e re në Plazh.
14. Të vendoset sinjalistika në Rrethrrotullimin e Shkozetit.
15. Të jepen leje për shitës ambulant për gratë në nevojë që duan të shesin punimet artizanale dhe pensionistë që shesin misra.

**Dëgjesat Publike 2025-2027**
**Proçes-Verbal**

**Dëgjesa V**

Data 15.10.2024.

Vendi i takimit: Palestra e shkolles "Naim Babameto", Spitallë, Durrës.

Ora: 10°°-14°°

Në këtë takim kishte një pjesmarrje të gjerë, ku të pranishëm ishin përfaqësues të komunitetit të Njësisë Administrative, përfaqësues të grupeve të interesit, përfaqësues të Këshillit Bashkiak, Institucioneve Arsimore, OSHE, Emergjenca Civile, Ujësjellës-Kanalizime, OJF që operojne në këtë Nj.A Nr.4.
Pjesmarrës në takim, sipas listë prezencës, 54 persona.

Takimin e hapi N/Kryetari i Bashkisë, Z. Elio Jani. Në fjalën e tij ai tha:
Përshëndetje të gjithëve. Sot jemi në ditën e pestë të realizimit të dëgjesave publike për buxhetin e vitit 2024 dhe PBA 2025-2027 për Njësinë Administrative Nr.4 ku do tju prezantojmë investimet që janë bërë në këto njësi, gjithashtu do tju prezantojmë dhe projektet e reja që do të zbatohen përgjatë harkut kohor 2025-2027. Në fund të prezantimit të të tre programeve nga drejtorët, do të bashkëbisedojmë për të dëgjuar kërkesat dhe sugjerimet tuaja.
Më tej dëgjesa vazhdoi me prezantimin e tre programeve buxhetore për PBA 2025-2027, të cilët u prezantuan nga Drejtorët e Drejtorive përkatëse të Bashkisë Durrës.
U prezantuan objektivat për investimet në infrastrukturë rrugore në Projekt Buxhetin e vitit 2025-2027, ndërtimin e 30 rrugëve në Njësinë Administrative Nr.4, ndërsa projektet në infrastrukturën publike për vitin 2025-2027 përfshijne rikonstruksionin dhe ndërtimin e qendrave shëndetësore, rikonstruksion dhe ndërtimin e kopsheve dhe cerdheve, krijimin e hapësirave publike si dhe kënde lojërash për fëmijë, ndërtimin e terreneve sportive, ndricim i rrugëve si dhe pastrimin dhe rehabilitimin e sistemit të kullimit të cilat do të jenë prioritet për vitet e ardhshme. Një nga projektet më madhorë që do të fillojë së shpejti është ndërtimi i Unazës Durrës, Rruga Pjetër Bogdani dhe Rruga Isuf Ferra si dhe ndërtimi i parkut linear Urban në Spitallë.
Pas prezantimit të këtyre programeve, fjalën e morën banorët dhe të pranishmit në sallë, të cilët diskutuan rreth këtyre prioriteteve, duke dhënë mendimet dhe duke parashtruar kërkesat dhe sugjerimet e tyre.

**Dëgjesa publike për Programin "Arsimi parashkollor dhe parauniversitar " dhe programi "Shërbimet Publike, Investimet në Arsim" PBA 2025-2027**

Më pas e mori fjalën Drejtori në Drejtorinë e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe komunitete Fetare, z. Adrian Gurra, i cili bëri prezantimin për programin "Arsimi parashkollor dhe parauniversitar dhe investimet në arsim" **për PBA 2025-2027.**

**Qëllimi i takimit:** Përthithja nëpërmjet Dëgjesave Publike, të mendimeve dhe sugjerimeve të aktorëve të ndryshëm të fushës për të realizuar një buxhet sa më pranë qytetarëve dhe nevojave të tyre. Përcaktimi i prioriteteve të investimeve në Arsim në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së infrastrukturës arsimore, duke ofruar shërbime eficente dhe cilësore për vitin në vazhdim 2024 dhe për projekt buxhetin afatmesëm 2025-2027.

**Prezantimi i Drejtorit të Arsimit, z. Adrian Gurra**

z. Gurra, bëri një analizë të detajuar mbi arsimin dhe objektivat e tij deri në vitin 2027, investimet e bëra nga Bashkia Durrës në vitin 2024, dhe cilat janë ato që do të kryhen për vitet 2025-2027. Ai**,** cilësoi rëndësinë që kanë këto Dëgjesa Publike, dhe sa i rëndësishëm është fakti që së bashku ne diskutojmë mbi politikat që ka ndjekur Bashkia deri më sot dhe cilat janë ato deri në vitin 2027, duke bërë të mundur që nga diskutimet e përbashkëta të vendosim sa më mirë dhe drejt për prioritetet në fushën e arsimit, kulturës dhe sportit.

z. Gurra, prezantoi, programin e Arsimit parashkollor dhe parauniversitar, referoi për të gjitha investimet e kryera në Institucionet Arsimore gjatë vitit 2024 duke u ndalur kryesisht për cdo investim të kryer në Njësinë Administrative të Durrësit. Fokusi kryesor i investimeve në arsim, ishte ai i procesit të rindërtimit si dhe në investimet që parashikohen të bëhen në institucionet arsimore gjatë viteve 2025-2027.



## 1. Përmirësimi i infrastrukturës

- Përmirësimi i infrastrukturës në Bashkinë e Durrësit kryhet nëpërmjet dy programeve që nga tërmeti i 26 Nëntorit 2019 :

**1-Programit të Rindërtimit**

**2-Programit te investimeve me fondet e veta të NJQV (Bashkisë Durrës)**

**Programi i Rindërtimit**

Bashkia Durrës ka në proces rindërtimi 38 objekte, nga të cilat 30 kanë përfunduar dhe 8 janë në proces si më poshtë:

- 30 objekte te perfunduara (22 ndertime te reja/8 rikonstruksione)
- 8 objekte në proces (6 ndertime te reja/2 rikonstruksion)

**Financimet e procesit të rindërtimit të ndara sipas donatorëve**

- 13 objekte FShZh
- 18 objekte UNDP(EU4Schools) financim BE
- 1 objekt KFW gjermane financim qeveria gjermane
- 4 objekte CIS (Community Infrastructure Support) Danimark + Mbretëri e Bashkuar
- 2 objekte me financim nga të ardhurat e veta të Bashkise Durres

## 1- Programi i Rindërtimit

### Ndertime te reja ne proçes

1. Shkolla Mesme Sportive "Benardina Qerraxhi ", Durrës/Nentor 2024
2. Konvikti I shkollës "Bernardina Qeraxhi", Durrës /Nentor 2024
3. Konvikti I vjetër I shkollës "Beqir Çela", Durrës/Janar 2025
4. Shkolla Mesme Bashkuar "Rexhep Mezini ", NJA Ishëm/Shkurt 2025
5. Shkolla e Mesme Manëz/ne pritje te tenderimit (Ndertim I ri, financim me fondet e Bashkisë Durrës, eshte ne faze vleresimi perfundimtar dhe brenda muajit Nentor 2024 fillon puna).
6. Shkolla 9 vjeçare "Vadardhë", NJA Sukth /ne proces hartimi specifikime teknike

### Rikonstruksionnë proçes

1. Shkolla 9 vjecare " Kushtrimi i Lirise ", Durrës/Me Vendim KSHR-je kalon ne programin e rindertimit me programin EU4Schools, zbatuar nga UNDP/project propozimet per konsultim publik
2. Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare "Riza Shera" Radë dhe Kopësht/perfunduar punimet, ne pritje te lidhjes se energjise elektrike dhe kolaudimit

## Objekte te perfunduara brenda vitit 2024, nga programi i rindertimit

- Ne vitin 2024 kanë përfunduar dhe kane nisur procesin mesimor:
- Shkolla 9 vjeçare "Eftali Koci", Durrës / mars 2024
- Shkolla 9 vjeçare "14 Nëntori", Durrës / shtator 2024
- Shkolla e Mesme e Bashkuar "Jusuf Hoti"+ kopësht dhe shkollë fillore / shtator 2024
- Gjimnazi "Naim Frashëri",Durrës / shtator 2024
- Kopshti i shkolles 9 vjecare "Isuf Ferra", Nishtulla, Durrës/shtator 2024
- Palestra shkollës 9 vjeçare "Isuf Ferra", Nishtulla, Durrës /shtator 2024

## 2-Programi i dytë: Investime me fondet e veta të NJQV (Bashkisë Durrës)

VITI 2025-26

- Ndërtim shkolla 9 vjeçare "Met Hasa "/proces lidhje kontrate
- Ndërtim shkolle e re nga bashkimi i 2 shkollave 9 vjeçare: "Vasil Ziu" dhe "Nënë Tereza" /2026
- Ndertim I terreneve te mbyllura sportive ne shkollat 9 vjecare "Jusuf Puka" dhe "Abedin Dino"
- Rikonstruksion total shkolla 9 vjecare "Bajram Curri"

VITI 2027

- Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare "Hamza Muca"
- Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare "Jubë"
- Rikonstruksion godina e shk 9 vj "Bishtkamëz"
- Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare "Pal Zefi", Rrushkull

## Objekte te perfunduara brenda vitit 2024, nga program me fonde te Bashkise Durres

VITI 2024

- Rikonstruksion shkolla MB "Besnik Hidri", Shënvlash/perfunduar Janar 2024
- Rikonstruksion Qendra Kulturore e Fëmijëve/perfunduar Qershor 2024
- Rikonstruksion gjimnazi "Dom Nikoll Kaçorri"/perfunduar Shtator 2024
- Ndërtim terreni sportiv i mbuluar multifunksional ne bashkefinancim me World Vizion ne shkollen e Re, Kenete (drejt perfundimit)
- Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare "Demokracia"/perfundon ne nentor 2024
- Ndertim kabine elektrike dhe pajisje per shkollat "Naim Frasheri" dhe "Benardina Qerraxhi"

## Objekte arsimore rajoni 4 dhe Rajoni 6

- Shkolla 9 vjeçare "Demokracia" (Rikonstruktuar me fondet e BD/perfundon nentor 2024).
- Shkolla 9 vjeçare"Neim Babameto"Ndërtim I ri FSHZH 2020
- Kopshti shkolles 9 vjeçare "NeimBabameto "/Rikonstruktuar me fondet e B.Durres/kthyer ne kopesht me ushqim
- Shkolla 9 vjeçare "Met Hasa" (Ne proces lidhje kontrate, fillon puna brenda vitit 2024)
- Shkolla 9 vjecare e Re, Kënetë/(sistem ngrohje dhe sistem elektrik bashkefinancim World Vision 2020),bashkëfinancim World Vision-Bashkia Durrës, terren multidisiplinar të mbuluar /përfunduar shtator 2024)
- Shkolla e mesme Dom Nikoll Kacorri (Rikonstruksion total + ndertim palester me fonde te BD/perfunduar shtator 2024)

**Foto nga Degjesa Publike për Programin “Arsimi parashkollor dhe parauniversitar ” dhe programi “Shërbimet Publike, Investimet në Arsim”**
**PBA 2025-2027 me Nj.A Nr.4 dhe Nr.6**





**Dëgjesa Publike e Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publik për PBA 2025-2027 me Nj. Administrative Nr.4 dhe Nr.6**

Më pas e mori fjalën Drejtori i Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike , z.Lorenc Facja, i cili bëri prezantimin e Programit të Projekteve dhe Investimeve të Infrastrukturës Publike për PBA 2025-2027.

**Prezantimi i drejtorit të Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike** .

Drejtori i Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike , z.Lorenc Facja, u bëri të ditur pjesëmarrësve se këto takime po bëhen në kuadër të realizimit të dëgjesave publike për të bërë të mundur më pas përgatitjen e Buxhetit Afatmesëm 2025-2027 lidhur me investimet në infrastrukturën rrugore dhe shërbimet publike.

z.Facja, informoi të pranishmit lidhur me programin e **"Infrastrukturës rrugore dhe Transportit Publik"**, duke u përqëndruar kryesisht në informimin e pjesëmarrësve mbi investimet e kryera gjatë vitit 2024, në Njësine Administrative Nr.4 dhe Nr.6, dhe parashikimi për investimet në infrastrukturën rrugore për këto Njësi Administrative gjatë tre viteve në vazhdim 2025-2027.
Bashkia Durrës, në buxhetin e saj për vitin 2024, ka planifikuar të investojë në infrastrukturën rrugore, përzgjedhja e rrugëve ku do të investohet, është bërë në bashkëpunim të ngushtë me stafin e Njësive Administrative, gjithashtu duke pasur parasysh dhe kërkesat e banorëve të zonës për problematika të ndryshme.
z.Facja, theksoi se: Si në zonën e Spitallës dhe Durrësit të Ri, Kënetë, kemi realizuar investime si në infrastrukturë rrugore, ndricim dhe ujë kanalizime, shumë të tjera janë në proces.



## 2. PASTRIM KANALESH KULLUESE TE REALIZUAR

Kanal kullues 1365 ml






## 3. OBJEKTIVAT PER VITIN 2025-2027

PROJEKTE NE INFRASTRUKTURE RRUGORE NE VITIN 2025

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Rajoini 4 | LAGJIA 18 | KRYQEZIMI RRUGES BLERIMI(NGJIT ME PALLATIN E BASHKISE) L.18 | 50 | 3.5 | 175 |
| Rajoini 4 | LAGJIA 18 | RRUGA VASO PASHA | 50 | 4 | 200 |
| Rajoini 4 | LAGJIa 18 | RRUGA HORIZONTI + DY KRYQEZIME TE RRUGES HORIZONTI | 160 | 7 | 1120 |
| Rajoini 4 | LAGJIA 18 | KRYQEZIM I RRUGES KRISTO SOTIRI | 55 | 4 | 220 |
| Rajoini 4 | LAGJIA 18 | KRYQEZIMI NR2 I RRUGES KRISTO SOTIRI | 100 | 4.5 | 450 |
| Rajoini 4 | LAGJIA 18 | MBRAPA DYLIT, L.18 | 35 | 4 | 140 |
| Rajoini 3 | PORTO ROMANO | SHENPALI | 600 | 3 | 1800 |
| Rajoini 4 | PORTO ROMANO | KANDAVIA | 600 | 4 | 2400 |
| Rajoini 4 | PORTO ROMANO | PERENDORI HADRIAN | 350 | 4 | 1400 |
| Rajoini 4 | PORTO ROMANO | GJERGJ BALSHAJ | 800 | 4 | 3200 |
| Rajoini 4 | PORTO ROMANO | RRUGA 235 | 990 | 4 | 3960 |
| Rajoini 4 | PORTO ROMANO | GREGOR HAN | 355 | 4 | 1420 |
| Rajoini 4 | PORTO ROMANO | REXHEP MEZINI | 320 | 4 | 1280 |
| Rajoini 4 | SPITALL | DIAMANTI-ALEKSANDER GOGA | 125 | 3 | 375 |
| Rajoini 4 | SPITALL | PERANDORI JUSTINIAN | 200 | 3 | 600 |
| Rajoini 4 | SPITALL | AMBRA | 80 | 3 | 240 |
| Rajoini 4 | SPITALL | RRUGA PREZA DEGEZIM RR MARINES | 70 | 3 | 210 |
| Rajoini 4 | SPITALL | SUPERMAKETI VISHES | 160 | 3 | 480 |
| Rajoini 4 | SPITALL | RRUGA FUSHA | 570 | 3 | 1710 |
| Rajoini 4 | LAGJA 17 | RRUGA XHELADIN BALLA | 380 | 3 | 1140 |
| Rajoini 4 | LAGJA 17 | LAGJA LULE | 200 | 3.5 | 700 |
| Rajoini 4 | LAGJA 17 | RRUGIC XHANFIZE KEKO | 165 | 3 | 495 |
| Rajoini 4 | LAGJA 17 | RRUGA 339 | 230 | 3 | 690 |
| Rajoini 4 | LAGJA 17 | RRUGOCA DARDANIA | 120 | 3 | 360 |
| Rajoini 4 | LAGJA 8 | PJETER BOGDANI | 430 | 3.5 | 1505 |
| Rajoini 4 | LAGJA 8 | SHPRESA | 560 | 3.5 | 1960 |
| Rajoini 4 | LAGJA 8 | RRUGA 83 | 50 | 3 | 150 |
| Rajoini 4 | LAGJA 8 | BLESAR | 160 | 3 | 480 |
| Rajoini 4 | LAGJA 8 | MBRAPA SPITALIT | 220 | 3.5 | 770 |
| Rajoini 4 | LAGJA 8 | KASTRIOT | 900 | 5 | 4500 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Rajoini 6 | ISH KENET | VELA BLU | 170 | 4 | 680 |
| Rajoini 6 | ISH KENET | LYDRA | 170 | 4 | 680 |
| Rajoini 6 | ISH KENET | DANUBI | 746 | 6 | 4476 |
| Rajoini 6 | ISH KENET | JUBA | 750 | 6 | 4500 |
| Rajoini 6 | ISH KENET | VALBONA | 640 | 3.5 | 2240 |
| Rajoini 6 | ISH KENET | PIREU | 250 | 3.5 | 875 |
| Rajoini 6 | ISH KENET | VOLLGA | 550 | 5 | 2750 |
| Rajoini 6 | ISH KENET | DREJTESIA | 210 | 4 | 840 |
| Rajoini 6 | ISH KENET | NAUM VEGJILARXHI | 210 | 4 | 840 |

# 4. PROJEKTE NE INFRASTRUKTURE PUBLIKE 2024

- Krijimin e hapsirave publike dhe kende lodrash per femije sheshi ne Spitalle
- Rikonstruksion i varrezave te reja.
- Pastrim dhe rehabilitim te sistemit te kullimit dhe ndertim i hidrovorit Porto Romano.
- Ndertim i Qendres Shendetesore Spitalle.









## 5. PROJEKTE NE INFRASTRUKTURE PUBLIKE 2025-2027

-Rikonstruksion dhe ndertim i qendrave shendetesore

-Rikonstruksion dhe ndertim te kopeshteve/çerdheve

-Krijimin e hapsirave publike dhe kende lodrash per femije

-Ndertimin e terreneve sportive

-Ndricim i rrugeve.

-Pastrim dhe rehabilitim te sistemit te kullimit

-Ndertimin e parkut linear Urbane ne Spitalle

-Ndertim i unazes Durres, Rruga Pjeter Bogdani dhe Rruga Isuf Ferra









**Foto nga Dëgjesa Publike për programin e “Infrastrukturës rrugore dhe Transportit Publik”, për PBA 2025-2027 me Nj.Administrative Nr.4 dhe Nr.6**





**Dëgjesa Publike për Programin "Projektet e Shërbimit Social" PBA 2025-2027**
**Drejtoria e Shërbimit Social me Nj. Administrative Nr.4 dhe Nr.6**

Më pas e mori fjalën Drejtorja e Drejtorisë së Shërbimit Social znj. Meme Xhaferraj, e cila bëri prezantimin e **"Projekteve të Shërbimit Social" për PBA 2025-2027**

**Qëllimi i takimit:** Informimi i pjesëmarrësve me politikat e përmirësimit të kushteve për zhvillimin e sistemit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror në Bashkinë Durrës dhe përmirësimi i shërbimeve sociale në territorin e Bashkisë Durrës për vitin në vazhdim 2024, dhe marrja e opinioneve të tyre për të përmirësuar shërbimet sociale dhe shërbimet e përkujdesit shoqëror për projekt buxhetin afatmesëm 2025-2027.

**Prezantimi i drejtores së Drejtorisë së Shërbimit Social**

Drejtorja e Drejtorisë së Shërbimit Social znj. Meme Xhaferraj, u bëri të ditur pjesëmarrësve se këto takime po bëhen në kuadër të realizimit të dëgjesave publike për të bërë të mundur më pas përgatitjen e Buxhetit Afatmesëm 2025-2027 lidhur me projektet e Shërbimit Social.

Ajo, theksoi se Bashkia Durrës ka hartuar Planin e shërbimeve sociale dhe të Kujdesit Shoqeror, i cili është bazuar në qasjen e ofrimit të një pakete shërbimesh për të gjitha kategoritë e grupeve në nevojë, janë përcaktuar llojet e shërbimeve, tipet e shërbimeve, dhe shtrirja e tyre në territor.

Gjatë prezantimit, znj.Meme Xhaferraj bëri një pasqyrë të situates aktuale, detyrat dhe përgjegjësitë e Pushtetit Vendor si dhe u ndal në shërbimet sociale që po kryhen në Bashkinë e Durrësit gjatë vitit 2024 dhe për vitet 2025-2027.

Bashkia e Durrësit, vitet e fundit, ka shtuar llojin dhe shtrirjen në territor të shërbimeve të kujdesit shoqëror, në të cilin kemi përfshirë persona të moshës së tretë, personat me aftësi të kufizuar, fëmijët të cilët ndodhen në një situatë rreziku, viktima të dhunës në familje, viktima të trafikimit të qenjeve njerëzore.

Qëllimi i ofrimit të shërbimeve, është që ti garantojmë mbrojtje, integrim dhe përfshirje, të gjithë këtyre grupeve apo individëve. Për komunitetin Rom dhe Egjiptian, ne kemi pasur dhe një plan veprimi.
Znj. Meme Xhaferraj, përmendi Qendrat që ofrojnë sherbime:

- Qendra Ditore e të Moshuarve, e cila ka vite që ofron shërbime dhe kujdes për moshën e tretë.
- Qendra Ditore për Fëmijët me Aftësi të Kufizuar, ngritur mbas vitit 2018, në të cilën, jo vetëm PAK marrin shërbime, por punohet si për parandalimin, si për identifikimin e hershëm apo dhe mbështetjen që duhet të kenë në familje dhe komunitet këto persona.
- Qendra e Shërbimeve Emergjente,Mbrojtëse dhe Fuqizuese për Fëmijet dhe Familjen. Kjo Qendër funksionon terësisht me fondin e Bashkisë, por ështe aplikuar dhe mbeshtetur me Organizatën Ëorld Vision dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes

Sociale. Në këtë Qendër kanë marrë shërbime fëmijët që kanë qenë në situatë rreziku dhe nënat që kanë qenë viktima të dhunës në familje,

- Qendra Komunitare Multifunksionale në Rrashbull, pra kemi shtrirje të shërbimeve jo vetëm brenda qytetit, por dhe në zonat rurale.
- Qendra e Këshillimit për Familjen në Sukth, e cila është buxhetuar tërësisht këto vite me buxhetin afatmesëm. Gjithashtu ne shohim dhe mundësitë e partneriteteve me organizata kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe me financime nga pushteti qendror
- Shtëpia e Foshnjës, për të cilën Bashkia e Durrësi është përzgjedhur dhe dy bashki të tjera me qëllim ofrimin e shërbimeve dhe quhen qendra residence për fuqizimin e komuniteteve. Kjo Qendër Rezidence ka shërbyer dhe për njerëzit me nevoja sidomos pas tërmetit, ndodhet tek ambjentet e ish shkollës “Faik Konica”, dhe ka shërbime tëgjera dhe nga terreni, gra për mbështetje, mundësi për punësim, të moshuar, apo fëmijëqë kanë nevojë për fizioterapi apo logoped.

Znj. Xhaferraj tha se jemi në fazën e identifikimit të zonave ku nuk ka shërbime për PAK.

Ajo, cilësoi se, Bashkia e Durrësit, përsa i përket ndihmës ekonomike në të vërtetë ka pak familje dhe si e tillë shihet si një Bashki, me një numër të ulët të varfërisë.

Gjithashtu, znj.Meme Xhaferraj prezantoi në slaidera shërbimet, përfituesit dhe financimet e kryera në këto qendra të Bashkisë së Durrësit, si më poshtë:



## Qendra Komunitare për Fëmijë me Aftësi të Kufizuar

13

Qendra ofron shërbime që synojnë rehabilitimin dhe gjithëpërfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla dhe komunitet, nëpërmjet ndërhyrjes me trajtime të individualizuara, mbështetjes së familjes dhe ndërgjegjësimit komunitar.

1

**Shërbimet:**

**I.** Shërbim direkt për fëmijët me aftësitë kufizuara (2-21 vjeç) në fushën e sjelljes, komunikimit, autonomisë, aftësive akademike dhe motorikës.

